



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT PËR VITIN 2025

Prishtinë, qershor 2026

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit
- 4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) nuk paraqesin në mënyrë të saktë vlerën e pasurive, pasi që pasuritë kapitale janë mbivlerësuar për 3,130,548€ si rezultat i mbajtjes në regjistra të projekteve të përfunduara edhe pas pranimit teknik dhe përfshirjes së pagesave të regjistruara gabimisht si pasuri e Ministrisë, ndërsa pasuritë jo kapitale janë nënvlerësuar për 1,193,168€ për shkak të mos përfshirjes së të gjitha raporteve të njësive vartëse të MKRS-së në regjistrin e pasurive;
- A2 Mbivlerësim i regjistrin të obligimeve për 1,019,223€, për shkak të përfshirjes së faturave që nuk i përkasin vitit raportues, apo pa dëshmi që mbështesin obligimin;
- A3 Detyrimet kontigjente janë nënvlerësuar për 718,181€, për shkak të mosparaqitjes së disa detyrimeve kontigjente, për të cilat janë siguruar dëshmi të mjaftueshme që vërtetojnë se janë padi aktive.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A4 Ministria kishte nënshkruar kontratat në vlerë 12,783,110€ dhe 10,971,578€ pa verifikuar paraprakisht vlefshmërinë e sigurimeve të ekzekutimit dhe të garancisë së avancit;
- B1 Në njëmbëdhjetë (11) raste, në vlerë 1,814,747€, nuk ishin dorëzuar raportet për arsyetimin e shpenzimeve nga përfituesit e subvencioneve siç përcaktohej me marrëveshje;
- A5 Në pesë (5) raste, në vlerë prej 1,721,042€, federatat sportive janë financuar duke anashkaluar procedurën e thirrjes publike;
- A6 Në pesë (5) raste në vlerë 1,296,464€, paradhëniet për kontratat në investime kapitale janë dhënë në kundërshtim me kufizimet dhe kërkesat ligjore;
- B2 Në pesëmbëdhjetë (15) raste janë evidentuar vonesa në pagesën e faturave në vlerë totale prej 998,410 €. Pagesat nuk janë kryer brenda afatit të përcaktuar ligjor, ndërsa vonesat variojnë nga 20 deri në 480 ditë kalendarike, duke treguar mosrespektim të afateve të pagesave sipas rregullave në fuqi;
- B3 Në dy (2) raste, në vlerë 103,500€, Ministria kishte ndarë subvencione jashtë afatit dhe në mospërputhje me rregulloret në fuqi;
- B4 Pagesat e realizuara në kuadër të kontratës kornizë kanë tejkaluar vlerën maksimale të lejuar të kontratës, përfshirë tolerancën prej +30%, në shumën prej 87,520€ apo 11%;
- A7 Mospërputhje ndërmjet punimeve të paguara dhe atyre të realizuara në vlerë 80,861€ për pozicione që nuk janë ekzekutuar sipas specifikimeve kontraktuale ose nuk janë realizuar fare;
- A8 Mungesa e dëshmimeve për pajisjen me leje ndërtimore para fillimit të aktiviteteve ndërtimore tregon dobësi në sigurimin e përmbushjes së kërkesave ligjore dhe procedurale, duke rritur rrezikun e zbatimit të projekteve pa bazën e nevojshme ligjore;
- B5 MKRS ka planifikuar disa kontrata të mëdha për investime kapitale duke mos përgatitur dhe publikuar njoftimin paraprak në fillim të vitit, ashtu siç kërkohet me rregulloret në fuqi, duke krijuar mosrespektim të afateve të planifikimit të prokurimit publik;
- A9 Biblioteka Kombëtare e Kosovës (BKK) kishte bërë klasifikimin e pozitave të punës jo në pajtim me shtojcën përkatëse në Ligjin për Pagat në sektorin publik;
- A10 Procesi i subvencionimit të OJQ-ve është karakterizuar me mangësi në planifikimin e thirrjes publike, respektimin e kërkesave rregullative, dokumentimin e procesit të vlerësimit dhe verifikimin e dokumentacionit të aplikantëve, duke ndikuar në transparencën, paanshmërinë dhe integritetin e procesit të përzgjedhjes së përfituesve.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Çështje tjetër

- 1 Gjatë vitit 2025, Ministria ka funksionuar si një entitet i vetëm me buxhet të përbashkët. Megjithatë, duke filluar nga viti 2026, ajo është riorganizuar në dy institucione të ndara: Ministrinë e Kulturës dhe Turizmit dhe Ministrinë e Sportit dhe Rinisë, secila me buxhetin e vet të veçantë. Për rrjedhojë, rekomandimet e paraqitura në këtë raport u adresohen të dyja ministrive, në përputhje me fushat përkatëse të përgjegjësisë.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

UD Sekretari i MKRS është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, UD Sekretari i MKRS është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjisllacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit janë identifikuar disa fusha që kërkojnë përmirësim, përfshirë aspektet e kontrollit të brendshëm. Këto janë paraqitur në vijim në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve për shqyrtimin tuaj.

Sfidat kryesore janë evidentuar në mbajtjen në regjistra e pasurive kapitale që duhej të ishin transferuar te përfituesit përfundimtarë dhe mospërfshirjen e të gjitha pasurive jo kapitale në regjistrat e pasurisë, mbivlerësimi i regjistrit të obligimeve për shkak të raportimit të pasaktë si dhe mosparaqitjen e plotë e detyrimeve kontigjente në pasqyrat financiare.

Në aspektin e pajtueshmërisë me legjislacionin dhe rregulloret në fuqi, nevojitet përmirësim i kontrolleve dhe mbikëqyrjes në fushat që lidhen me dhënien e paradhënies, financimin e federatave sportive, menaxhimin dhe dokumentimin e projekteve ndërtimore, klasifikimin e pozitave të punës, verifikimin e garancive dhe sigurimeve kontraktuale, respektimin e afateve dhe procedurave për ndarjen e subvencioneve, raportimin e shpenzimeve nga përfituesit e subvencioneve, si dhe menaxhimin e kontratave kornizë në përputhje me kufijtë e përcaktuar ligjorë dhe kontraktualë.

Gjetjet dhe rekomandimet e paraqitura synojnë përmirësimin dhe korrigjimin e informacionit financiar të raportuar në pasqyrat financiare, përfshirë shpalosjet në shënimet shpjeguese, si dhe forcimin e kontrolleve të brendshme në funksion të raportimit financiar dhe pajtueshmërisë me kërkesat ligjore për menaxhimin e fondeve publike.

Ky raport përmban gjithsej njëzet e katër (24) rekomandime, nga të cilat trembëdhjetë (13) janë rekomandime të reja, dhjetë (10) janë të përsëritura dhe një (1) rekomandim është pjesësisht i përsëritur. Zbatimi i këtyre rekomandimeve do të monitorohet dhe vlerësohet në kuadër të auditimit të vitit pasues.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 5.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Mangësi në menaxhimin, bartjen e pronësisë dhe raportimin e pasurive jo-financiare

Gjetja Sipas nenit 13, të rregullores MF-Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare, të gjitha transaksionet e krijuara gjatë ndërtimit të pasurisë jo financiare për organizatat tjera buxhetore duhet të regjistrohen në regjistrat e organizatës financuese në kategorinë e investimeve në vijim dhe në momentin kur pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e dorëzimit, organizata buxhetore financuese do të mbyllë llogarinë e investimeve në vijim.

Sipas rregullës financiare 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore, neni 17,1 në harmoni me LMFPP-në organizatat buxhetore raportojnë për pasuritë jo financiare. Si dhe, raportet për pasuritë që paraqiten nga organizatat buxhetore ndër të tjera përfshijnë: 3.2. pasuritë jo kapitale që kanë vlerë deri 1,000€ të regjistruara në “e-pasuria”.

Regjistri i pasurive kapitale janë mbivlerësuar për 3,130,548€ si rezultat i mangësive të identifikuara si në vijim:

- Ministria vazhdon të mbajë në regjistrat e saj pasuritë kapitale në vlerë 2,664,923€⁵ edhe pas përfundimit të projektit dhe realizimit të pranimeve teknike. Këto pasuri nuk janë transferuar tek njësitë përfituese apo përdoruese përfundimtare, siç kërkohet me procedurat dhe kornizën ligjore në fuqi. Si rezultat, regjistrat e Ministrisë përmbajnë pasuri që faktikisht nuk janë më nën menaxhimin apo kontrollin e saj, duke krijuar mospërputhje ndërmjet gjendjes reale në terren dhe regjistrat të pasurisë; si dhe
- Në regjistrat e pasurisë janë regjistruar gabimisht dy pagesa si pasuri kapitale, njëra për rekuizita kulturore në institucione të kulturës (institucione që nuk janë vartëse të ministrisë) në vlerë 457,025€ dhe një pagesë në vlerë 8,600€ e cila nuk ishte investim kapital për nga natyra, dhe të njëjtat nuk përfaqësojnë pasuri në pronësi apo kontroll të Ministrisë, duke ndikuar në paraqitjen jo të saktë të vlerës së pasurisë.

Vlen të theksohet se në regjistra janë evidentuar edhe projekte të përfunduara dhe në përdorim të cilat datojnë që nga viti 2014 për të cilat nuk është zhvilluar procesi i bartjes tek përfituesit pas përfundimit të projekteve. Të njëjtat figurojnë në regjistra si investime në vijim.

Ndërsa, regjistri i pasurive nën 1,000€ e prezantuar në PFV ishte nënvlerësuar për 1,193,168€ për shkak të mangësive në konsolidimin e të dhënave nga të gjitha njësitë vartëse. Në shënimet e shpalosura është reflektuar vetëm vlera e pasurive të Administratës Qendrore dhe jo vlera e plotë e të gjitha njësitë vartëse. Si rrjedhojë, informacioni financiar nuk paraqet në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen reale të pasurive nën 1,000€ të MKRS-së. Vlera e pasurive të cilat nuk ishin të reflektuara në raportin e pasurive në PFV sipas njësive ishte:

- Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës (ASHAK) 741,606€;
- Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës (AMKMK) 17,463€;
- Biblioteka Kombëtare e Kosovës (BKK) 434,099€.

Mosdorëzimi i pasurisë kapitale pas përfundimit të projekteve është rezultat i mungesës së një sistemi efektiv të monitorimit të procesit të përcjellës dhe përfundimit të procedurave të dorëzimit të projekteve të përfituesit, moszbatimi në kohë të kërkesave ligjore për menaxhimin e pasurisë kapitale.

Po ashtu, për shkak mungesës së koordinimit dhe komunikimit të duhur me njësitë vartëse gjatë përgatitjes së PFV-ve.

Ndikimi

Mosbartja e pronësisë së investimeve të përfunduara dhe raportimi jo i plotë i pasurive jo-financiare dobësojnë menaxhimin efektiv të pasurive dhe në prezantimin e drejtë të gjendjes dhe vlerës së tyre në PFV.

Rekomandimi A1

Ministri duhet të ndërmarrë veprimet e nevojshme për trajtimin e të gjitha objekteve/investimeve të financuara nga Ministria, të cilat i kanë plotësuar kushtet për dorëzim-bartje të pronësisë tek përfituesit, si dhe në bashkëpunim me Thesarin të sigurojë zbatimin e të gjitha procedurave për dorëzimin e pasurive dhe regjistrimin e tyre si pasuri në përdorim në regjistrat përkatës të institucioneve përfituese. Po ashtu, të sigurohet koordinim dhe komunikim më efektiv ndërmjet të gjitha njësive vartëse dhe zyrës së financave, me qëllim të konsolidimit të plotë dhe prezantimit të saktë të vlerave financiare në PFV, si dhe zbatimin e kontrolleve efektive

për të garantuar regjistrimin me kohë të pasurive.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Mbivlerësim i regjistrit të obligimeve

Gjetja Neni 17, pika 3, i Rregullores MF - Nr. 01/2017- Për raportim vjetor të pasqyrave financiare të organizatave buxhetore, thotë: "Organizatave buxhetore raportojnë të gjitha detyrimet (faturat) të krijuara deri më 31 dhjetor të vitit raportues."

Regjistri i obligimeve në PFV, është mbivlerësuar për 1,019,223€, si rezultat i përfshirjes së tri (3) faturave në vlerë të përbashkët 1,011,222€, ndonëse protokollimi i tyre është bërë në shkurt të vitit 2026. Ndërsa, në një (1) rast tjetër është identifikuar mungesa e kontratës dhe vendimit për dhënien e subvencionit/përkrahjes financiare. Obligimi ishte evidentuar nga departamenti përgjegjës bazuar në evidencat e disponueshme për përkrahjen me subvencion, pa dokumentacionin formal mbështetës, duke rezultuar në mbivlerësim të obligimeve për 8,000€.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mangësive në zbatimin e kontrolleve të brendshme në procesin e pranimit dhe protokollimit të faturave.

Ndikimi Mbivlerësimi i regjistrit të obligimeve paraqet raportim të pasaktë financiar, ku vlera e obligimeve e shpalosur është mbivlerësuar në PFV.

Rekomandimi A2 Ministri duhet të sigurojë se po zbatohen kontrollet e duhura të konfirmimit se raportimi i obligimeve në pasqyra financiare përfshinë gjendjen e obligimeve të periudhës raportuese, me qëllim që obligimet dhe pasqyrat financiare të prezantohen në mënyrë të saktë dhe të drejtë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Prezantim jo i plotë dhe jo i saktë detyrimeve kontigjente

Gjetja Neni 6 i Rregullores 01/2017 për Raportimin Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore përcakton se " Organizatat Buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare".

Regjistri i detyrimeve kontigjente i shpalosur në Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) ishte nënvlerësuar për 718,181€, si pasojë e mangësive të identifikuara më poshtë:

- Nënvlerësim i detyrimeve kontigjente të shpalosura në PFV në vlerë prej 730,322€ për shkak të raportimit jo të plotë të tyre. Të njëjtat ishin të përfshira në PFV-të e vitit 2024 me vlerë zero. Sipas regjistrit, rastet kishin të bënin me kompensimet e shujtave dhe pagave jubilarë, për të cilat ishte bërë vlerësimi financiar por nuk ishin përfshirë në regjistrin e prezantuar në pasqyra; si dhe
- Mbivlerësim i detyrimeve kontigjente për shkak të përfshirjes së vendimit përmbartimor në vlerë 12,151€ në regjistër.

Këto mangësi kanë ndodhur për shkak të kontrolleve të pamjaftueshme në procesin e identifikimit, klasifikimit, vlerësimit dhe raportimit të detyrimeve kontigjente, si dhe në saktësinë dhe plotësinë e regjistrit para shpalosjes në PFV.

Ndikimi Shpalosja jo e plotë dhe e saktë e detyrimeve kontigjente ndikon që palët e interesit apo që shfrytëzuesit e PFV-ve të mos informohen drejtë dhe saktë, duke pasur ndikim negativ në vendimmarrje.

Rekomandimi A3 Ministri duhet të sigurojë që përmes forcimit të kontrolleve të brendshme dhe bashkëpunimit me departamentin ligjor, kryhet verifikim i plotë dhe i detajuar i regjistrit të detyrimeve kontigjente përpara prezantimit të tyre në PFV, me qëllim të sigurimit që të dhënat të jenë të sakta, të plota dhe në përputhje me kërkesat e raportimit financiar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A4 - Nënshkrimi i kontratave pa verifikimin paraprak të sigurimit të ekzekutimit

Gjetja Sipas dosjes së tenderit, seksioni II. Fleta e të dhënave të tenderit, neni 14.1 dhe 14.2 është kërkuar siguria e ekzekutimit 20% i vlerës së kontratës për 30 ditë më shumë se koha e realizimit të kontratës.

Ministria ka nënshkruar kontratat për projektet “Renovimi i Stadiumit të Qytetit në Gjilan” në vlerë 12,783,110€, e nënshkruar më 20.05.2025 dhe “Stadiumi i Qytetit Suharekë” në vlerë 10,971,578€, e nënshkruar më 12.08.2025 pa e bërë verifikimin paraprak të vlefshmërisë së sigurimeve të ekzekutimit. Si pasojë, Ministria ka pranuar sigurime të ekzekutimit të cilat nuk ishin të vlefshme në momentin e nënshkrimit të kontratave. Për më tepër, për projektin “Stadiumi i Qytetit Suharekë” është konstatuar se edhe garancia e avancit ishte pranuar pa u verifikuar paraprakisht. Sipas konfirmimeve të pranura përmes zyrtarëve të Ministrisë nga kompanitë përkatëse të sigurimit, pas kërkesës nga ana e auditorëve, siguritë e ekzekutimit të dorëzuara fillimisht nuk ekzistonin ose kanë qenë jo valide në kohën e ofrimit të tyre. Pas nënshkrimit të kontratave dhe pas fillimit të punëve, këto sigurime si dhe garancia e avancit janë ndryshuar nga operatorët ekonomik me dokumente tjera të vlefshme gjatë vitit 2026.

Autoriteti kontraktues nuk kishte vendosur kontrolle efektive për verifikimin e vlefshmërisë së sigurimeve të ekzekutimit dhe garancive bankare para nënshkrimit të kontratave, duke mundësuar pranimin e dokumenteve të pavlefshme nga operatorët ekonomik.

Ndikimi Pranimi i sigurisë së ekzekutimit jovalide ka rezultuar në mosmbulimin efektiv të rrezikut kontraktual për periudhën gjashtë (6), respektivisht tetë (8) mujore dhe ka dobësuar mekanizmat e kontrollit në procesin e prokurimit, duke e ekspozuar autoritetin kontraktues ndaj rrezikut të mosrealizimit të obligimeve kontraktuale pa mbrojtje adekuate financiare.

Rekomandimi A4 Ministri nëpërmjet zyrtarëve përgjegjës të prokurimit, duhet të sigurojë që, para nënshkrimit të kontratës, të bëhet verifikimi i plotë i vlefshmërisë së sigurisë së ekzekutimit pranë institucioneve lëshuese. Gjithashtu, të rrisë nivelin e llogaridhënies, duke instaluar kontrolle para se kontrata të procedohet për nënshkrim final, me qëllim të eliminimit të rreziqeve financiare për institucionin.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B1 - Mos arsyetimi i shpenzimeve për subvencioneve

Gjetja Ministria me qëllim të përkrahjes së kulturës në përgjithësi, përveç tjerash, bënë edhe subvencionimin e projekteve të ndryshme kulturore dhe sportive, qoftë të entiteteve publike apo atyre jo publike. Subvencionet jepen në formë të avanceve me qëllim që të njëjtat të arsyetohen sipas marrëveshjeve të nënshkuara kryesisht në fund vit, apo bartësit e projekteve obligohen që t'i arsyetojnë shpenzimet e realizuara në bazë të afateve të parapara në kontrata.

Në 11^e raste të testuara, në vlerë 1,814,747€, përfituesit e subvencioneve nuk kishin dorëzuar raportet për arsyetimin e shpenzimeve me kohë, të cilat, sipas marrëveshjeve, do të duhej të ishin mbyllur deri në fund të vitit 2025 dhe, për më tepër, avancet figurojnë ende të hapura.

Kjo ka ndodhur si pasojë e funksionimit jo të duhur të sistemit të monitorimit të shpenzimeve të federatave nga MKRS, si dhe mungesës së mekanizmave adekuat që do të siguronin raportimin në kohë të projekteve të subvencionuara.

Ndikimi Vonesat në arsyetimin e subvencioneve nga federatat dhe përfituesit tjerë sipas afateve të përcaktuara në marrëveshjet e nënshkuara, e bëjnë të pamundur vlerësimin nëse janë arritur objektivat e ministrisë dhe nëse është arritur vlera për para. Mosdorëzimi i raporteve dhe mungesa e arsyetimit për projektet e subvencionuara mund të ndikojë negativisht në buxhetin e ministrisë dhe të rrisë rrezikun e përdorimit të fondeve për qëllime të tjera nga ato të parashikuara.

Rekomandimi B1 Ministri duhet të siguroj se të gjitha projektet e subvencionuara arsyetohen në kohën e paraparë në përputhje me kërkesat e memorandumit, mbështetur me dokumente valide të parapara me rregulloren për subvencione. Në rastet e mos arsyetimit të subvencioneve, të ndërmerren veprimet ligjore, siç parashihet me marrëveshjet përkatëse.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A5 - Anashkalimi i thirrjes publike në financimin e aktiviteteve shtesë të organizatave sportive**

Gjetja Neni 18, paragrafi 1, i Rregullores (QRK)-Nr. 36/2024 për procedurat dhe kushtet e financimit të Organizatave Sportive, përcakton që, Agjencia për Sport, bazuar në prioritetet e Strategjisë Shtetërore për Sport, programeve dhe politikave shtetërore, duke përfshirë edhe organizimin e garave ndërkombëtare, hap thirrjen "financim për funksionimin dhe realizimin e aktiviteteve shtesë për të gjitha organizatat që veprojnë sipas fushëveprimit të kësaj rregulloreje". Më tutje, paragrafi 3, në thirrjen e Agjencisë përcaktohen kushtet e financimit dhe informacionet për procedurën e aplikimit, në përputhje me këtë rregullore. Thirrja publikohet në uebfqen e Ministrisë.

Në pesë (5) raste, në vlerë 1,721,042€, ishin financuar federatat sportive për organizimin e aktiviteteve shtesë, në kundërshtim me dispozitat e rregullores dhe duke anashkaluar thirrjen publike. Financimi i aktiviteteve shtesë është miratuar bazuar në kërkesat e federatave sportive gjatë vitit,

për aktivitetet si vijon:

- Kampionati Evropian U16 Kosovë-Shqipëri, me vlerë financimi prej 231,530€, për Federatën e Volejbollit;
- Kampionati Evropian CS2 (meshkuj dhe femra) dhe Dota2 (meshkuj), me vlerë financiare 1,053,000€, për Federatën ESports Kosova;
- Kampionati Evropian i femrave U17 - Gusht 2025, me vlerë financiare 150,120€, për Federatën e Hendbollit;
- Fiba U16 Euro basket 2025 dhe Fiba Europe U14 (Get-together 2025), me vlerë financiare 161,886€, për Federatën e Basketbollit;
- WTT Youth Contender Prishtina dhe WTT Feeder Prishtina 2025 - me vlerë financiare 124,506€, për Federatën e Ping Pongut.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e mosfunksionimit të mekanizmave të kontrollit në mbikëqyrjen dhe zbatimin e kritereve të përcaktuara në rregulloren në fuqi.

Ndikimi

Anashkalimi i thirrjes publike ndikon në uljen e transparencës dhe efikasitetit në përdorimin e fondeve publike për financimin e aktiviteteve shtesë të organizatave sportive siç kërkohet me rregulloren në fuqi.

Rekomandimi A5

Ministri duhet të funksionalizojë mekanizmat e kontrollit dhe mbikëqyrjes në procesin e zbatimit të rregullores për financimin e organizatave sportive, duke siguruar që financimi i aktiviteteve shtesë të realizohet përmes thirrjes publike në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, me qëllim të rritjes së transparencës, efikasitetit dhe barazisë në shpërndarjen e fondeve publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A6 - Pagesa të paradhënies në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi

Gjetja

Ligji nr. 08-L-332 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e republikës së Kosovës për vitin 2025, neni 13, pagesat e paradhënies, në muajin nëntor të vitit 2025 pagesa e paradhënies është e kufizuar deri në dhjetë përqind (10%) dhe në muajin dhjetor të vitit 2025 deri në pesë përqind (5%) të vlerës së kontratës.

Është konstatuar se procesi i pagesave të paradhënies për kontratat në investime kapitale nuk ka respektuar kufizimet ligjore në fuqi, duke rezultuar në pagesa të paradhënies përtej limiteve të lejuara. Rastet e identifikuara janë si në vijim:

- Për projektin “Renovimi i stadiumit të qytetit në Ferizaj”, në dhjetor është parapaguar 10% e vlerës së kontratës në shumën 1,734,209€, në vend të 867,105€ (5%) sa ishte e lejuar;
- Për projektin “Qendra multifunksionale në Dragash”, në nëntor është realizuar pagesë në vlerë 100,000€, në vend të 98,995€ (10%) sa ishte e lejuar;
- Për projektin “Stadiumi i Prizrenit”, avanci ishte ekzekutuar në dy pjesë, nëntor dhe dhjetor. Pagesa e pjesës së avancit të realizuar në dhjetor ishte 707,558€, në vend të vlerës 603,779€ (5%) sa ishte e lejuar;
- Për projektin “Renovimi i Pallatit të Rinisë” në dhjetor është

ekzekutuar pagesa e avancit për 15% (171,778€) të vlerës së kontratës, në vend të 57,259€ (5%) sa ishte e lejuar.

Krahas tyre, për projektin “Renovimi i kompleksit të sportit dhe palestra sportive në Gjilan” me vlerë kontrate 2,878,876€, është realizuar pagesë në mars 2025 në vlerë 13% ose 383,000€, pa dëshmi të mjaftueshme për destinimin e mjeteve siç ishte e specifikuar në kushtet e veçanta të kontratës.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e menaxhimit jo të drejtë të nevojave buxhetore në përputhje me planin e realizimit të kontratave dhe sipas kufizimeve të përcaktuara ligjore.

Ndikimi Pagesat e paradhënieve përtej limiteve të përcaktuara ligjore ndikojnë në përdorim jo efikas të mjeteve buxhetore, duke rritur rrezikun për keqmenaxhim të fondeve dhe mosrealizim të duhur të kontratave.

Rekomandimi A6 Ministri duhet të forcojë mekanizmat e kontrollit të brendshëm dhe të sigurojë zbatimin e plotë të kërkesave ligjore gjatë procesit të pagesës së paradhënieve për kontratat në investime kapitale, si dhe vlerësimin e drejtë të nevojave buxhetore në përputhje me planin e realizimit të kontratave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B2 - Vonesa në pagesën e faturave

Gjetja Sipas nenit 39.1 të ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, "Çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës".

Në pesëmbëdhjetë (15) raste, faturat në vlerë prej 998,410 € nuk janë paguar në afatin e paraparë ligjor. Vonesat variojnë nga 20 deri 480 ditë kalendarike.

Vonesat ishin të shkaktuara nga mungesa e mjeteve buxhetore dhe planifikimi jo i mirë për kryerjen e obligimeve sipas afateve të përcaktuara.

Ndikimi Vonesat në pagesa ndaj furnitorëve rrisin rrezikun që në periudhat e ardhshme ministria të ballafaqohet me padi gjyqësore/përmbartimore të cilat njëherit rezultojnë me shpenzime shtesë duke e rënduar buxhetin e ministrisë.

Rekomandimi B2 Ministri duhet të sigurojë vendosjen e një sistemi efektiv në të cilin të gjitha faturat të procedohen me kohë për pagesë sipas afatit të përcaktuar ligjor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Subvencione jashtë afatit dhe në mospërputhje me kornizën ligjore në fuqi**Gjetja**

Rregullorja MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve si dhe, Rregullorja Nr. 09/2015 për subvencionimin në fushën e kulturës, trashëgimisë kulturore, rinisë dhe sportit nuk parasheh financimin për Institucionet me status të Institucionit të Pavarur Publik. Ndërsa, sipas nenit 20, paragrafit 1 të Rregullores Nr. 14/2022 për kategorizimin e sportistëve dhe trajnerëve: sportistët dhe trajnerët, përmes klubeve të tyre i drejtohen federatës përkatëse për të dorëzuar aplikacionin për kategorizim deri me datën 15 dhjetor. Më tutje, paragrafi 3, përcakton që, komisioni i vlerësimit nuk do të marrë në shqyrtim aplikacionin e pakompletuar apo që është dorëzuar pas datës 31 dhjetor.

MKRS kishte lidhur memorandum bashkëpunimi me Radiotelevizionin e Kosovës (RTK) në vlerë prej 100,000€ për transmetimin e ndeshjeve të Kombëtares së Kosovës në futboll për muajt mars dhe qershor 2025, pavarësisht se RTK është transmetues publik i financuar nga Kuvendi.

Gjithashtu, kemi vërejtur se MKRS, duke u mbështetur në kategorizimin e sportistëve dhe trajnerëve për vitin 2025, kishte dhënë subvencion në një rast në vlerë 3,500€ jashtë afateve të përcaktuara ligjore. Kërkesa për financim ishte paraqitur individualisht, jo përmes federatës, dhe pas datës 31 dhjetor, në kundërshtim me rregulloren në fuqi.

Kjo kishte ndodhur si shkak i mos funksionimit të kontroleve të brendshme në respektimin dhe zbatimin e drejtë të rregulloreve në fuqi për subvencionim.

Ndikimi

Ndarja e subvencioneve në kundërshtim me kornizën ligjore në fuqi ndikon në mbështetjen e projekteve që nuk përputhen me objektivat e përcaktuara, duke ulur efikasitetin në shpërndarjen e fondeve publike. Po ashtu, financimi jashtë afateve të parapara ligjore dëmton transparencën dhe barazinë në trajtimin e përfituesve.

Rekomandimi B3

Ministri duhet të forcojë kontrollet e brendshme dhe mekanizmat e mbikëqyrjes, me qëllim të parandalimit të miratimit të subvencioneve jashtë afateve të përcaktuara me rregullore, si dhe të sigurojë që mbështetja e projekteve të jetë në përputhje me objektivat e përcaktuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B4 - Tejkallim i vlerës së kontratës****Gjetja**

Neni 1, paragrafi 1.4 i kontratës përcakton që kontrata hyn në fuqi me 16.10.2023 dhe përfundon me 15.10.2026. Po ashtu, sipas kontratës, neni 4, çmimi i total i ofertës do të jetë në vlerë financiare 800,000€ (+/-30%).

Për kontratën kornizë "Shërbimet e prodhimit të spoteve televizive dhe dokumentarëve për nevojat e MKRS-së", në vlerë 800,000€ (+/- 30%), janë realizuar pagesa në shumën totale 1,127,522€. Si rrjedhojë, vlera e pagesave ka tejkaluar kufirin e lejuar të kontratës (duke përfshirë tolerancën +30%) për 87,520€, ose 11%.

Vlen të theksohet se për të njëjtën kontratë ishte raportuar edhe në vitin 2023 si dobësi në aplikimin e procedurave të prokurimit.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme, përkatësisht nga menaxheri i kontratës, gjatë realizimit të kontratës kornizë.

- Ndikimi** Mungesa e kontrolleve efektive në menaxhimin e kontratës, duke pranuar shërbime/furnizime përtej limiteve të lejuara me kontratë, ndikon në realizimin e pagesave jo sipas kontratës, shpenzime të paplanifikuara, duke ndikuar po ashtu në konkurrueshmërinë dhe transparencën lidhur me shpenzimin e fondeve publike.
- Rekomandimi B4** Ministri duhet të forcojë mekanizmat e kontrollit të brendshëm për menaxhimin e kontratave kornizë, duke siguruar që shpenzimet të jenë në përputhje vlerat e kontraktuara, me qëllim të shmangjes së tejkallimeve buxhetore dhe përdorimit efikas të buxhetit të saj.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A7 - Pagesa të realizuara për punë të pakryera

- Gjetja** Sipas nenit 70.23, të rregullores nr. 001/2022 për prokurim publik menaxheri i kontratës do të sigurojë që operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë. Regjistri i punës, forma, mënyra dhe kushtet për mbajtjen e librit ndërtimor dhe ditarit ndërtimor janë përcaktuar në Udhëzimin Administrativ të MMPH Nr.15/2013 mbi kushtet për mbajtjen e ditarit ndërtimor dhe librit ndërtimor.

Gjatë verifikimit në terren të mostrave të audituara në prill 2026, si dhe shqyrtimit të dokumentacionit teknik për projektin “Ndërtimi i stadiumit të atletikës në Kamenicë” në vlerë 3,491,579€, është konstatuar se:

- Punët përgatitore të punishtes (Pozicioni I.1): Sipas projektit, ky pozicion përfshin fillimin e punimeve dhe përgatitjen e punishtes, duke përfshirë edhe vendosjen e zyrave të përkohshme. Në terren është evidentuar vetëm një kontejner i përdorur për mjete pune, ndërsa mungon kontejneri i paraparë për stafin menaxherial dhe mbikëqyrës, i pajisur me hapësirë pune dhe inventar përkatës. Ky pozicion është paguar në vlerë prej 26,961€, megjithëse nuk është realizuar në përputhje me specifikimet kontraktuale;
- Punët e asfalt-betonit (Pozicioni IV.1): Ky pozicion përfshinë furnizimin, transportin dhe shtrimin e shtresës bazë të asfalt-betonit (0-16 mm) me trashësi t=7 cm për hapësirat e destinuara për dysheme sintetike (shtigjet e vrapimit). Ky pozicion është paguar në vlerë prej 53,900€, ndërkohë që gjatë verifikimit në terren është konstatuar se punimet përkatëse nuk janë realizuar fare.

Në anën tjetër, është konstatuar se libri ndërtimor nuk është plotësuar në mënyrë të rregullt dhe të plotë, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në udhëzimin administrativ përkatës. Konkretisht, mungojnë të dhëna thelbësore, përfshirë skicimet dhe përlllogaritjet e sasive sipas projektit, si dhe nuk është siguruar paraqitje e qartë dhe e veçantë për secilin pozicion. Për më tepër, një numër i konsiderueshëm i pozicioneve janë evidentuar në të njëjtën fletë, pa kalkulime dhe pa detaje përkatëse, duke vështirësuar verifikimin e saktësisë së punimeve të raportuara.

Shkaku kryesor lidhet me kontrolle të pamjaftueshme nga ana e mbikëqyrjes së projektit, si dhe me mungesën e një zbatimi të qëndrueshëm të kërkesave administrative për plotësimin e saktë dhe të detajuar të librit ndërtimor

Ndikimi Kjo gjendje rrit rrezikun e aprovimit dhe realizimit të pagesave për punë të papërfunduara ose të realizuara pjesërisht, duke ndikuar në përdorimin joefikas të mjeteve publike. Në anën tjetër, mangësitë në librin ndërtimor pamundëson verifikimin e saktësisë së sasive dhe punimeve të realizuara, duke rritur rrezikun për pagesa të pasakta dhe dobësim të kontrollit financiar.

Rekomandimi A7 Ministri duhet të sigurojë forcimin e mbikëqyrjes dhe kontrollit të procesit të certifikimit të situacioneve, duke siguruar që asnjë pagesë të mos kryhet për punë të papërfunduara ose të realizuara pjesërisht.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A8 - Mungesa e lejes ndërtimore para inicimit të projekteve kapitale

Gjetja Sipas Nenit 9, paragrafit 1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, para se të fillohet me ushtrimin e çfarëdo aktiviteti të prokurimit, autoriteti kontraktues duhet të sigurojë një vlerësim formal të nevojave që ndër të tjera përcakton llojin dhe përmasat e sakta të projektit. Po ashtu, neni 27, paragrafi 4 i të njëjtit ligj specifikon se dosja e tenderit duhet të kompletohet tërësisht para publikimit të njoftimit të kontratës. Sipas ligjit Nr. 04/L-110 për ndërtim neni 14-llojet për të cilat lëshohet leja ndërtimore: 1.1 ndërtimi i ri (përfshirë montazhet), 1.2 rindërtimi i objekteve ekzistuese.

Në kuadër të projektit Stadiumi i Qytetit në Suharekë në vlerë 10,971,578€ është identifikuar se për këtë projekt nuk është siguruar dëshmi e mjaftueshme që konfirmon pajisjen me leje ndërtimore para fillimit të aktiviteteve ndërtimore.

Nga dokumentacioni i shqyrtuar dhe informacionet e disponueshme, nuk është gjetur evidencë që autoritetet kompetente kanë lëshuar leje ndërtimore në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi, ndërkohë që aktivitetet e prokurimit lidhura me këto projekte janë zhvilluar.

Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve efektive të brendshme dhe mosverifikimit të mjaftueshëm të përmbushjes së kërkesave ligjore, përfshirë sigurimin e lejes ndërtimore nga autoritetet kompetente, para inicimit dhe zhvillimit të projekteve kapitale.

Ndikimi Mos sigurimi i lejes ndërtimore para fillimit të projekteve mund të rezultojë me ndërprerje të punimeve nga organet kompetente, vonesa në realizimin e projekteve dhe kosto shtesë financiare për buxhetin publik.

Rekomandimi A8 Ministri duhet të sigurojë që para inicimit të çdo projekti ndërtimor të verifikohet dhe dokumentohet pajisja me leje ndërtimore në përputhje me kërkesat ligjore, duhet të forcohen kontrollet e brendshme për të parandaluar fillimin e punimeve pa dokumentacionin e nevojshëm ligjor dhe të vendosen mekanizma monitorimi për të garantuar përputhshmërinë gjatë gjithë periudhës së projektit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B5 - Mungesa e njoftimit paraprak**Gjetja**

Neni 6, paragrafi 6.2 i Rregullores për Prokurim publik përcakton: " Nëse AK ka qëllim të dhënies së kontratave gjatë periudhës së ardhshme prej 12 muaj, të një ose më shumë kontratave për furnizime, shërbime ose punë të cilat kanë një vlerë të parashikuar, prej 500,000€ ose më shumë, afati kohorë i përgatitjes së njoftimit indikativ nga zyrtari i prokurimit është: a. në rast të Njoftimit Paraprak për furnizime ose shërbime sa më shpejtë që është e mundshme pas fillimit të vitit fiskal.

MKRS kishte planifikuar kontrata të mëdha në investime kapitale si: "Punë ndërtimore për zbatimin e hollësishëm (zbatues-kryesor) të rregullimit hapësinor, të arkitekturës dhe inxhinierisë për rindërtimin dhe përshtatjen e stadiumit të Gjilanit" në vlerë 12,783,110€, Ndërtimi i qendrës nacionale të xhudos në Pejë" në vlerë 5,776,32€, "Ndërtimi i stadiumit të qytetit në Suharekë" në vlerë 10,971,578€. Megjithatë, nuk kishte përgatitur dhe publikuar njoftimin paraprak në fillim të vitit siç kërkohet me rregullore.

Kjo ka ndodhur si pasojë e funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme, përfshirë mungesën e koordinimit ndërmjet njësive përgjegjëse, vonesat në procesin e miratimit dhe verifikimit të dokumentacionit, si dhe mungesën e monitorimit të rregullt të afateve ligjore dhe procedurale, gjë që ka ndikuar në mos përgatitjen dhe mos publikimin e njoftimit paraprak për këto kontrata.

Ndikimi

Mungesa e njoftimit paraprak ndikon në mos përmbushjen e rregullave të prokurimit publik dhe njëkohësisht e ulë edhe transparencën për OE që të njoftohen dhe përgatiten në kohë reale për prokurimet e mundshme.

Rekomandimi B5

Ministri duhet të sigurojë që njoftimi paraprak të përgatitet dhe publikohet në përputhje me rregullat e përcaktuara në Rregulloren për Prokurim Publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A9 - Mangësi në ekuivalentimin dhe klasifikimin e pozitave të punës në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës.****Gjetja**

Sipas nenit 7, paragrafit 4, pikës 4.7 të Ligjit nr. 08/L-245 për Artin dhe Kulturën, në institucionet publike qendrore të artit dhe kulturës përfshihet: Biblioteka Kombëtare e Kosovës. Gjithashtu, kjo përcaktohet edhe në Shtojcën 12 të Ligji Nr. 08/L-196 për Pagat. Më tutje, neni 80, paragrafi 8, i Ligjit për Zyrtarët Publik Nr. 08/L-197, përcakton që, pozitat e punës klasifikohen në kategori, në klasa dhe grupe të njëjta, sipas përshkrimit dhe kërkesave të punës. Po ashtu, neni 4, paragrafi 1, pika 1.4 i Ligjit të pagave Nr. 08/L-196, parimi i barazisë dhe mos-diskriminimit - nënkupton që secili, pa kurrëfarë diskriminimi, ka të drejtë që për punë të barabartë të marrë pagë të barabartë, duke marrë parasysh natyrën e punës, kërkesat për vendin e punës, institucionin ku ushtrohet detyra si dhe kualifikimin.

Gjatë vitit 2025, Biblioteka Kombëtare e Kosovës ka bërë ekuivalentimin e pagave bazuar në Shtojcën nr. 12 - "Krijuesit dhe performuesit e artit dhe kulturës" për dy departamente profesionale, duke u mbështetur në rregulloren e vjetër për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës. Kjo ka ndodhur pasi institucioni ende nuk e kishte hartuar rregulloren për klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës, ndërsa deri në fund të vitit 2025 nuk e kishte finalizuar atë në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Nga pesë (5) mostra të testuara në BKK, janë identifikuar mangësitë në vijim:

- Në dy (2) raste, punonjësit e BKK-së ishin klasifikuar nga pozita I15 - Profesional 2 në kategorinë "Krijues/e dhe performues/e i/e artit dhe kulturës - Profesional 3", ndërsa sipas kërkesës fillestare të BKK-së drejtuar Thesarit këto pozita do të duhej të klasifikoheshin në kategorinë "Krijues/e dhe performues/e i/e artit dhe kulturës - Profesional 2";
- Në dy (2) raste, punonjësit e BKK-së nuk ishin klasifikuar në kategorinë "Krijues dhe Performues", megjithëse ishin përfshirë në listën e dorëzuar fillimisht ndaj Thesarit. Ndërkohë, brenda të njëjtit divizion, një pjesë e punonjësve të tjerë ishin kategorizuar në këtë kategori;
- Si dhe, në një (1) rast, kemi identifikuar se BKK kishte klasifikuar një punonjës nga pozita I15 - Profesional 2 në pozitën C14 - Nëpunës/e Kabineti 1, ndonëse kjo pozitë i përket departamentit profesional dhe, si e tillë, do të duhej të kategorizohej në kategorinë "Krijues dhe Performues", në përputhje me Shtojcën nr. 12.

Kjo ka ndodhur si pasojë e zbatimit jo të njëtrajtshëm dhe jo të drejtë të Ligjit për Pagat në sektorin publik dhe dispozitave të Shtojcës nr. 12 - "Krijuesit dhe performuesit e artit dhe kulturës", si dhe për shkak të mosekuivalentimit me kohë të pozitave të punës për punonjësit e BKK dhe kufizimeve buxhetore në kuadër të planifikimit financiar për vitin 2025.

Ndikimi

Mangësitë e identifikuar në procesin e ekuivalentimit të pagave kanë ndikuar në klasifikim dhe kompensim jo të drejtë të punonjësve, duke shkaktuar trajtim jo të barabartë për pozita të ngjashme, si dhe duke krijuar rrezik për pagesa jo adekuate dhe zbatim jo të duhur të legjislacionit në fuqi. Si pasojë, kjo situatë mund të rezultojë edhe me iniciimin e procedurave gjyqësore nga punonjësit ndaj BKK, duke shkaktuar kosto shtesë financiare për institucionin.

Rekomandimi A9

Ministri duhet të sigurojë që Menaxhmenti dhe Njësia e Burimeve Njerëzore e BKK-së të rishikojnë vendimet e nxjerra për kategorizimin e të punësuarve, duke korigjuar të gjitha rastet ku janë konstatuar mospërputhje sipas legjislacionit. Më tej, duhet të sigurohet se janë themeluar kontrolle të brendshme funksionale që garantojnë që çdo vendim i ardhshëm të bazohet në kriteret e përcaktuara me legjislacion, duke eliminuar çdo praktikë diskriminuese dhe duke siguruar njohjen e plotë të të drejtave ligjore për të gjithë të punësuarit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A10 - Mangësi në procesin e thirrjes publike/vlerësimit të subvencioneve**Gjetja**

Neni 13, paragrafi 1, pika 1.1 e Rregullores MF Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, përcakton se thirrja publike duhet të përmbajë udhëzimet për aplikantët dhe kriteret për përzgjedhjen e përfituesve. Ndërsa, neni 14, paragrafi 2, pikat 2.4 dhe 2.5, përcakton që udhëzimet të specifikojnë numrin e përafërt të kontratave që mund të financohen, shumën totale të mjeteve në dispozicion, si dhe kufijtë minimalë dhe maksimalë të financimit dhe numrin e prithshëm të projekteve që do të mbështeten. Po ashtu, neni 16, paragrafi 1, pika 1.1, Komisioni Vlerësues ka për detyrë të shqyrtojë aplikacionet nga aspekti procedural dhe të vlerësojë përmbushjen e kriterëve për mbështetje financiare publike, ndërsa paragrafi 2 parasheh që anëtarët e Komisionit të nënshkruajnë deklaratën e paanshmërisë dhe konfidencialitetit në vendimmarrje para vlerësimit. Si dhe, neni 17 i Rregullores (MKRS) Nr. 09/2015 për subvencionimin përcakton se komisioni për vlerësimin e projekteve duhet ta përfundojë punën e vetë brenda afatit prej 15 ditë pune, nga data e mbylljes së konkursit

MKRS, më datë 27.02.2025, kishte shpallur thirrje publike për subvencionimin e OJQ-ve në fushën e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore për vitin 2025. Megjithatë, me rastin e hapjes së thirrjes publike, udhëzimet për aplikantët nuk përfshinin numrin e përafërt të kontratave që mund të financoheshin, si dhe shumën e përgjithshme të mjeteve financiare në dispozicion për financim.

Po ashtu, thirrja ishte e ndarë në pesë (5) kategori për financim, por për kategoritë II-V nuk ishin përcaktuar shumat minimale për subvencionim për secilën kategori, siç kërkohet nga rregullorja në fuqi, por vetëm shumat më të larta të financimit.

Me rastin e shpalljes së thirrjes, MKRS kishte emëruar komisionin vlerësues për shqyrtimin e aplikacioneve, por nuk janë siguruar dëshmi për nënshkrimin e deklaratave të paanshmërisë dhe konfidencialitetit nga anëtarët e komisionit, në përputhje me kërkesat rregullative.

Procesi i vlerësimit të aplikacioneve është përcjellë me vonesa. Thirrja publike ishte mbyllur më 26.03.2025, ndërsa raporti me listën preliminare të OJQ-ve përfituese është publikuar më 08.07.2025, që nënkupton se procesi i vlerësimit ka zgjatur rreth 90 ditë nga data e mbylljes së thirrjes.

Gjithashtu, në dy (2) raste të testuara, kemi identifikuar se përfituesit e subvencioneve nuk kishin dorëzuar të gjitha dokumentet obligative të kërkuara sipas thirrjes publike:

- Në projekt-propozimin “Gjurmë e pavdekshme - Trashëgimia e Kaçanikut në epokën digjitale”, OJQ përfituese në kategorinë IV në vlerë prej 6,000€, nuk ishte bashkangjitur portfolion e aktiviteteve për dy vitet e fundit, dokument ky obligativ sipas konkursit;
- Në projekt-propozimin “Trashëgimia jeton”, gjithashtu OJQ përfituese në kategorinë IV në vlerë prej 6,000€, mungonte vërtetimi se nuk ka obligime financiare ndaj ATK-së, i cili po ashtu ishte dokument obligativ sipas kriterëve të konkursit.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e mosrespektimit të kriterëve të përcaktuara

në rregulloren për financimin e OJQ-ve, si dhe nga menaxhimi joefektiv i procesit të ndarjes së subvencioneve, numri i madh i aplikimeve dhe vështirësitë e shkaktuara nga aplikimi përmes e-mailit.

Ndikimi

Mosrespektimi i kriterëve të rregullores dhe menaxhimi joefektiv i procesit të ndarjes së subvencioneve ul transparencën, rrit rrezikun për konflikt interesi dhe cenon integritetin e procesit të vlerësimit. Vonesat në vlerësim e vështirësojnë verifikimin e arritjes së objektivave të ministrisë dhe njëkohësisht rrisin rrezikun e përdorimit të fondeve për qëllime të tjera. Po ashtu, mos përfillja e plotë e kërkesave sipas thirrjes publike mund të rezultojë në përzgjedhje jo të drejtë e të bazuar në kërkesa ligjore.

Rekomandimi A10

Ministri duhet të sigurojë zbatimin e plotë të kriterëve të rregullores në fuqi gjatë procesit të ndarjes së subvencioneve. Po ashtu, procesi i vlerësimit të projekteve për subvencionim të bëhet në përputhje me afatet kohore të parapara sipas rregullores për subvencionim dhe në bazë të kriterëve të parapara në thirrjet publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për kategorinë e pagave dhe mëditjeve arriti në 8,249,110€, nga i cili ishte shpenzuar 99.84%. Numri i të punësuarve i planifikuar sipas buxhetit ishte 831, ndërsa në fund të vitit u realizua me 780 të punësuar.

Çështja B6 - Mungesë e rregullore së brendshme për klasifikimin e pozitave të punës në kundërshtim me kërkesat ligjore

Gjetja Sipas nenit 34 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për klasifikimin e vendeve të punës në shërbimin civil, obligohen institucionet në fushën e veprimit të kësaj Rregulloreje të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se tre (3) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale të Kosovës kishin hartuar draft-rregulloret përkatëse, por ato nuk u finalizuan as gjatë vitit 2025. Ndërkohë, Biblioteka Kombëtare e Kosovës nuk kishte hartuar ende, as deri në fund të vitit 2025, Rregulloren për klasifikimin apo grupimin e pozitave të punës, siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

Ndryshimet e fundit në kuadrin ligjor që prekin sektorët e MKRS-së, veçanërisht në fushat e rinisë dhe sportit, kanë nxjerrë në pah nevojën për rishikimin e disa dispozitave të rregulloreve, duke shkaktuar vonesa në miratimin e tyre.

Ndikimi Mosfinalizimi i Rregullores për klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës, në përputhje me dispozitat ligjore, mund të ndikojë në strukturën organizative, ndarjen e përgjegjësive dhe menaxhimin e proceseve administrative.

Rekomandimi B6 Ministri duhet të sigurojë që të përshpejtohet procesi i hartimit dhe miratimit të rregulloreve, duke siguruar koordinim të ngushtë mes institucioneve dhe respektimin e afateve të përcaktuara sipas rregulloreve në fuqi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A11 - Përzgjedhja e kandidatit në kundërshtim me kriteret e konkursit

Gjetja Sipas konkursit të datës 23.09.2025 për pozitën Zyrtar i TI në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës, kriteret formale dhe specifike, Arsimimi, kërkohej: Diplomë e arsimit të lartë (Niveli i parë - Bachelor) në shkenca kompjuterike, inxhinieri informatike ose fusha përkatëse.

Në konkursin e shpallur nga Biblioteka Kombëtare e Kosovës (BKK) për pozitën Zyrtar i TI-së, kanë aplikuar gjithsej gjashtë (6) kandidatë të cilët ishin përzgjedhur në listën e ngushtë si kandidat që plotësojnë kriteret e aplikimit. Kandidati i suksesshëm i cili kishte nënshkruar kontratën, nuk e kishte të përfunduar nivelin e parë të studimeve (Bachelor) në shkenca kompjuterike, inxhinieri informatike apo fusha të ngjashme, siç kërkohej me

konkurs, por ishte në vitin e fundit të studimeve dhe këtë e kishte dëshmuar me një vërtetim të lëshuar nga Universiteti pas mbylljes së konkursit. Për këtë konkurs ishte pranuar një ankesë pas publikimit të njoftimit për kandidatin e suksesshëm, e cila ishte hedhur poshtë nga komisioni i ankesave.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mosfunksionimit të mekanizmave të kontrollit për zbatimin e drejtë të kriterëve të përcaktuara në konkurs nga ana e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (NjMBNj) të BKK-së.

Ndikimi

Mosrespektimi i kriterëve të konkursit cenon parimin e barazisë dhe meritokracisë në procesin e rekrutimit, duke ulur besueshmërinë dhe transparencën e këtij procesi.

Rekomandimi A11

Ministri duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit në mënyrë që gjatë zhvillimit të procedurave të rekrutimit të respektohen kriteret e përcaktuara në konkurs, dhe të garantohet transparencë, barazi dhe meritokraci.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra e shërbime dhe komunalitë në vitin 2025 ishte 7,458,104€, prej tyre ishin shpenzuar 6,424,059€ ose 86%. Shpenzimet për mallra dhe shërbime përfshijnë furnizimin me material shpenzues, mirëmbajtjen, pajisjet e teknologjisë informative, furnizimin me derivate, shpenzimet e qirasë, shërbimet kontraktuese, shërbimet komunale, si dhe shpenzime të tjera të ngjashme operative.

Çështja A12 - Mos publikimi me kohë i njoftimit për nënshkrimin e kontratës

Gjetja Neni 41/A i Ligjit për prokurim publik, -“ Thekson se njoftimi për nënshkrimin e kontratës” - LPP (version i konsoliduar) thotë: “Nëse autoriteti kontraktues ka nënshkruar një kontratë publike duke përdorur procedurat e hapura, të kufizuara, konkurruese me negociata, të negociuara pa publikim, procedurat e kuotimit të çmimeve, ose procedurat me vlera minimale, Autoriteti i tillë kontraktues brenda dy (2) ditëve pas nënshkrimit të kontratës së tillë, do të përgatisë njoftimin për nënshkrimin e kontratës në gjuhët e cekura në nenin 13 të këtij ligji”.

Në dy (2) mostra të prokurimit për procedura të pajtueshmërisë janë evidentuar vonesa në publikimin e njoftimit për nënshkrimin e kontratës pas nënshkrimit të kontratës, si në vijim:

- Në kontratën “Riparimi dhe rivitalizimi i trezorit të BKK-se-kati 2”, 11 ditë vonesë në publikimin e njoftimit për nënshkrimin e kontratës dhe
- Në kontratën “Furnizimi me pajisje të IT-se -ASHAK”, 32 ditë vonesë në publikimin e njoftimit për nënshkrimin e kontratës.

Vonesat në publikimin e njoftimeve për nënshkrimin e kontratave kanë ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve dhe mekanizmave efektivë të monitorimit që do të siguronin përmbushjen me kohë të obligimeve procedurale nga zyrtarët përgjegjës të prokurimit.

Ndikimi Periudha e gjatë mes nënshkrimit dhe publikimit të një kontrate është jo në përputhje me parimin, paraqet cënim të transparencës duke mos u njoftuar me kohë e publiku dhe operatorët tjerë ekonomik mbi nënshkrimin e kontratës dhe ekziston rreziku i lejimit të ndryshimeve të fshehta në atë kontratë .

Rekomandimi A12 Ministri të sigurojë që zyra e prokurimit, po i publikon me kohë të gjitha njoftimet mbi nënshkrimet e kontratave, për të qenë sa më transparent me publikun dhe operatorët e tjerë ekonomik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B7 - Angazhimi i konsulentëve përmes procedurave të prokurimit për mbulimin e pozitave të rregullta

Gjetja Ligji nr. 08/L-197 për zyrtarët publik, neni 101 marrëveshjet me shërbimet e veçanta lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik. Tutje, sipas rregullave për prokurim të shërbimeve të veçanta, neni 57 paragrafi 3 përcakton që, shërbimet e veçanta të cilat nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rekrutimit janë shërbime profesionale për të cilat Autoriteti Kontraktues ka nevojë por të cilat shërbime nuk mund t'i plotësojë me stafin që ka.

MKRS, përfshirë edhe institucionet vartëse të saj, kishte të angazhuar nga viti 2023 dhe tutje gjithsej 137 konsulentë përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta, të realizuara përmes procedurave të prokurimit publik. Nga analiza e natyrës së angazhimeve është konstatuar se këta persona kanë ushtruar funksione që i përkasin pozitave të rregullta organizative, si zyrtarë administrativë, ligjorë, financiarë, të arkivit, IT, vozitës, si dhe profile të tjera profesionale si historianë dhe etnologë. Keta individë janë angazhuar në keto departamente:

- Departamentin e trashëgimisë kulturore-103 konsulentë;
- Departamentin e kulturës-26 konsulentë;
- Departamentin e administratës qendrore-4 konsulentë; si dhe
- Departamentin e sportit-4 konsulentë.

Kjo kishte ndodhur për shkak të kontrolleve jo të duhura dhe mos aplikimit të drejtë të kërkesave ligjore.

Ndikimi Angazhimi i personelit për pozita të rregullta me kontrata për shërbime të veçanta përmes procedurave të prokurimit, ndikon në mos pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe në përzgjedhjen e stafit me përvojë dhe kualifikime jo adekuate për pozita të caktuara.

Rekomandimi B7 Ministri duhet të sigurojë që pozitat e rregullta të punës të përfshihen në planin e rekrutimeve dhe rekrutimi i tyre të bëhet përmes procedurave të rregullta të rekrutimit në përputhje me kërkesat ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B8 - Vonesa në mbylljen e avanceve për udhëtime zyrtare

Gjetja Sipas nenit 9, paragrafi 1 i Rregullores (QRK) Nr.06/2023 për Kompensimin për udhëtime zyrtare dhe shpenzime të përfaqësimit përcakton "Kërkesa për kompensim dhe shpenzime të vogla së bashku me të gjitha dëshmitë për shpenzimet financiare i dorëzohet njësisë përkatëse për buxhet dhe financa brenda pesëmbëdhjetë (15) ditë pune, nga dita e përfundimit të udhëtimit zyrtar". Po ashtu, Neni 10, paragrafi 4 përcakton: "Në rast kur zyrtari nuk kthen shumën, ajo do të ndalohej sipas sistemit të pagave".

MKRS, në nenin 20 të Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) kishte raportuar avance të paarsyetuara për udhëtime zyrtare në vlerë prej 25,681€. Nga kjo shumë, vlera prej 19,590€ ishin avance të pambyllura nga vitet paraprake (2010-2024), përderisa avance të pambyllura për vitin 2025 ishin në vlerë prej 973€, të cilat kishin kaluar afatin ligjor prej 15 ditëve.

Kjo gjendje ka rezultuar si pasojë e mungesës së veprimeve të duhura ligjore nga ana e ministrisë për kthimin e mjeteve nga zyrtarët përkatës.

Ndikimi Mos arsyetimi i shpenzimeve të udhëtimit zyrtarë dhe mos mbyllja e avanceve brenda afatit ligjor, rritë rrezikun që paratë të jenë përdorur në kundërshtim me qëllimet e synuara, rregullat e aplikueshme apo keqpërdorim të mjeteve publike.

Rekomandimi B8 Ministri duhet të sigurojë që të gjitha avancet për udhëtime zyrtare duhet të arsyetohen dhe shumat e pashpenzuara të kthehen në afat prej 15 ditësh pas kthimit nga udhëtimi. Në të kundërtën, duhet të sigurojë marrjen e

veprimeve ligjore ndaj personave përgjegjës të cilët nuk i kanë arsyetuar ose kthyer mjetet e pranuar-avancet.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 23,096,388€, prej tyre në 2025 ishin shpenzuar 22,978,674€ ose 99%. Këto shpenzime lidhen kryesisht me përkrahjen dhe financimin e projekteve të ndryshme në fushën e kulturës, sportit, rinisë dhe trashëgimisë kulturore. Ato përfshijnë mbështetje për aktivitete artistike dhe kulturore, zhvillimin e sportit dhe organizimin e ngjarjeve sportive, fuqizimin e iniciativave rinore, si dhe ruajtjen, promovimin dhe zhvillimin e trashëgimisë kulturore.

Çështja C1 - Formimi i komisioneve vlerësuese për subvencionim jo në përputhje me kërkesat ligjore

Gjetja

Neni 10, paragrafi 1, pika 1.1 e Rregullores (QRK)-Nr. 36/2024 për procedurat dhe kushtet e financimit të organizatave sportive, parasheh që për vlerësimin e aplikimeve, ministria përgjegjëse për sport emëron komisionin vlerësues prej pesë (5) anëtarësh, prej të cilëve: dy (2) anëtarë emërohen nga radhët e zyrtarëve të Agjencisë së Sportit, përfshirë njësinë përgjegjëse për financimin e organizatave sportive. Ndërsa, neni 3, paragrafi 1, pika 1.3 e Rregullorës Nr. 02/2012 për punën e këshillit të librit, përcakton se, njëri nga anëtarët e këshillit të librit duhet të jetë nga radhët e minoriteteve. Kurse, neni 8, paragrafi 5 i Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, specifikon se, Komisioni Vlerësues themelohet gjatë kohës sa thirrja publike është e hapur dhe emrat e anëtarëve të Komisionit Vlerësues bëhen publik brenda shtatë (7) ditëve pas themelimit të Komisionit.

Gjatë testimit të procesit të dhënies së subvencioneve, janë identifikuar dobësi në përbërjen dhe formimin e komisioneve vlerësuese, si vijon:

- Komisioni për vlerësimin e projekteve për financimin e organizatave sportive ishte emëruar në kundërshtim me rregulloren, pasi që në përbërjen e tij ishte vetëm një anëtar nga Agjencia e Sportit, në vend të dy (2) anëtarëve të parashikuar;
- Në ftesën publike për përkrahjen financiare për botimin e librave për vitin 2025, MKRS kishte emëruar Këshillin e Librit me mandat katërvjeçar. Megjithatë, përbërja e këtij këshilli nuk përfshinte një anëtar nga komunitetet joshumicë, siç kërkohet me legjislacionin në fuqi;
- Në Thirrjen Publike për financimin e OJQ-ve në fushën e kulturës, artit dhe trashëgimisë kulturore, komisioni vlerësues është themeluar 10 ditë pas përfundimit të afatit të thirrjes, dhe jo gjatë kohës së hapjes së saj, në kundërshtim me kërkesat e rregullores në fuqi.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mosrespektimit të plotë të kërkesave rregullative dhe ligjore gjatë emërimit të komisioneve vlerësuese, si dhe mungesës së kontrolleve të brendshme efektive dhe mbikëqyrjes adekuate në këtë proces.

Ndikimi

Emërimi i komisioneve vlerësuese në kundërshtim me kërkesat ligjore dhe jo sipas afateve të parapara dëmton transparencën dhe besueshmërinë e procesit të vlerësimit të projekteve të financuara dhe, rrit rrezikun për vendimmarrje që nuk bazohet në kriteret e përcaktuara.

Rekomandimi C1

Ministri duhet të sigurojë që komisionet vlerësuese për ndarjen e subvencioneve të formohen në përputhje me rregulloret në fuqi, me qëllim

garantimin e paanshmërisë, transparencës dhe besueshmërisë së procesit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 43,958,740€, prej tyre në 2025 ishin shpenzuar 34,870,835€ ose 79%. Këto shpenzime lidhen kryesisht me investimet kapitale në infrastrukturë, duke përfshirë renovimin dhe restaurimin e monumenteve të trashëgimisë kulturore, ndërtimin dhe modernizimin e palestrave sportive, si dhe zhvillimin e qendrave kulturore dhe rinore. Një fokus i veçantë i këtyre investimeve është përgatitja për Lojërat Mesdhetare, përmes përmirësimit të infrastrukturës sportive dhe përcjellëse, në mënyrë që të përmbushen standardet ndërkombëtare dhe të sigurohet organizim i suksesshëm i këtij event.

Çështja B9 - Vonesa në realizimin e punimeve

Gjetja

Sipas rregullores nr. 0001/2022 për prokurimin publik, pika 70.23 menaxheri i kontratës sigurojë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë. Po ashtu, secila kontratë publike ka të përcaktuar afatin kohor të implementimit.

Ne kemi identifikuar vonesa në realizimin e punimeve për përfundimin e projekteve të kontraktuara, e të cilat kanë të bëjnë me:

- Projekti për renovimin e stadiumit olimpik "Adem Jashari", i filluar në mars 2024, sipas Planit të Menaxhimit të Kontratës (PMK) të amandamentimit të kontratës së fundit në vlerë 3,272,562€, plani dinamik i përfundimit të punëve është shkurt 2026. Ndërsa, deri në maj 2026 ky projekt kishte përfunduar vetëm 41% të punëve;
- Projekti "Konservimi dhe ndërtimi i kompleksit memorial historik shtabi i ZOD-it të UÇK-së dhe muzeut në Glllogjan-Faza III-të" në vlerë 2,314,764€, sipas PMK do të duhej të përfundohej me dhjetor 2024. Për të njëjtin projekt ishte ekzekutuar pagesa në vlerë 74,186€ në tetor 2025, edhe pse nuk na është ofruar dëshmi se kishte kontratë valide apo ndryshime të kontratës bazë;
- Renovimi i palestrës sportive në Gjilan në vlerë 2,787,876€, gjatë ekzaminimit fizik në terren në prill 2026 është konstatuar se niveli aktual i realizimit të punimeve është nën planifikimin e paraparë. Duke marrë parasysh progresin e kufizuar të evidentuar, ekziston rreziku përfundimi i punimeve brenda afateve të përcaktuara të jetë i pa arritshëm.
- Projekti Qendra multifunkionale në Podujevë në vlerë 954,559€, për kontratën e nënshkruar më 14.06.2023 punët sipas PMK dhe kontratës është dashur të përfundojnë për 26 muaj, mirëpo pas konfirmimit të siguruar nga menaxheri i kontratës në maj 2026 punët ende nuk kanë përfunduar;
- Ndërtimi i memorialit të dëshmorëve të UÇK-së në Terstenik, Drenas në vlerë prej 49,887€, do të duhej të përfundonte me 14.12.2024, ndërsa sipas raportit të pranimit teknik, projekti ishte përfunduar në maj 2025, duke rezultuar me pesë (5) muaj vonesë, ndërsa për vonesa nuk janë aplikuar penalet;
- Shtëpia e familjes Koroglu në Mitrovicë do të duhej të përfundohej sipas PMK më 20.11.2025, mirëpo e njëjta me një vendim ishte shtyrë deri në janar 2026;
- Projekti "Ekspozita e përhershme në kompleksin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit - LOT 1" në vlerë 47,000€, përfundimi i punëve sipas PMK do të duhej të ishte mars 2025, ndërsa kërkesa për zgjatje të afatit ishte bërë në dhjetor 2025. Për të njëjtin projekt ishte

ekzekutuar pagesa në vlerë 29,500€ në dhjetor 2025 vetëm duke u bazuar në kërkesën për zgjatje të afatit nga menaxheri i projektit;

- Qyteti mesjetar i Novobërdës në vlerë prej 212,000€, sipas PMK fillimi i punëve janar 2025 dhe përfundimi pas gjashtë (6) muajsh. E njëjta në kohën e furnizimit nuk ishte sipas planit dinamik; si dhe
- Renovimi i Teatrit Kombëtar në vlerë 6,994,937€, e cila do të duhej të përfundonte në qershor 2026. Gjatë ekzaminimit fizik në terren në prill 2026 është konstatuar se niveli aktual i realizimit të punimeve në Teatrin Kombëtar është nën planifikimin e paraparë. Duke marrë parasysh progresin e kufizuar të evidentuar, ekziston rreziku që përfundimi i punimeve brenda afateve të përcaktuara të jetë i pa arritshëm.

Shkaku i kësaj gjendjeje lidhet me cilësinë e pamjaftueshme të projekteve ekzekutive, të cilat kanë kërkuar ndryshime dhe sqarime gjatë zbatimit, si dhe me menaxhim jo të mjaftueshëm të afateve të përcaktuara në dosje të tenderit.

Ndikimi Vonesat në realizimin e projekteve rezultojnë në rritjen e obligimeve kontraktuale, të cilat mund të krijojnë implikime buxhetore për vitet në vijim. Njëkohësisht, këto vonesa ndikojnë negativisht në arritjen e objektivave të përcaktuara të ministrisë.

Rekomandimi B9 Ministri përmes zyrtarëve përgjegjës duhet të sigurojë një analizë gjithëpërfshirëse të projekteve të filluara dhe të identifikojë arsyet e vonesave të kontratave dhe marrjen e veprimeve për realizimin/përfundimin e tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B10 - Menaxhimi i kontratave jo përmes platformës së e-prokurimit

Gjetja Sipas paragrafi 70.24. pika (f) të Rregullorës 001/2022 për Prokurimin Publik, funksionet e menaxherit të kontratës kërkojnë që për secilën kontratë “Të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik”.

Procesi i menaxhimit të kontratave nuk ishte plotësisht në përputhje me kërkesat ligjore, pasi që kontratat e ekzaminuara nuk menaxhoheshin përmes platformës elektronike. Bazuar në mostrat e audituara ne identifikuam që për këtë pjesë menaxherët e kontratave nuk kishin vendosur ndonjë informatë në modulën e-prokurimi edhe pse vazhdonin të ishin menaxher të kontratës. Moduli e-prokurimi nuk ishte aplikuar në kontratat e audituara as nga njësitë vartëse të saj.

Mungesa e njohurive të menaxherëve të kontratave për përdorimin e modulit e-prokurimi për menaxhimin e kontratave, ndikon në pamundësitë që menaxhmenti të merr informata të mjaftueshme, në kohën e duhur në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.

Ndikimi Mungesa e njohurive të menaxherëve të kontratave për përdorimin e modulit e-prokurimi për menaxhimin e kontratave, ndikon në pamundësitë që menaxhmenti të merr informata të mjaftueshme, në kohën e duhur në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.

Rekomandimi B10 Ministri duhet të sigurojë që të gjithë menaxherët e projekteve, aplikojnë menaxhimin e kontratave përmes sistemit elektronik të prokurimit publik, me qëllim të mbikëqyrjes më të lehtë nga menaxhmenti apo përdoruesit tjerë të mundshëm.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.5 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me kategori ekonomike mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale:

Çështja A13 - Mungesa e amendamentimit të kontratave në rastet e ndryshimeve të kushteve kontraktuale

Gjetja

Neni 71-“Ndryshimi i kontratës”, i Rregullores Nr. 001/2022 për prokurim publik thotë që ndryshimet e kontratës publike bëhen në rastin:

ii) Në rast të kontratave për punë, kur ndryshimi i kontratës nuk ka kosto financiare shtesë, duhet të iniciohet procedura për amendamentimin e kontratës. Aty ku ndryshohet kontrata me qëllim të ndryshimit të termeve dhe kushteve fillestare, amendamenti do të përgatitet nga Njësia e Prokurimit dhe duhet të nënshkruhet nga nënshkruesit e kontratës bazë.

Për projektet "Ekspozita e përhershme në kompleksin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit", "Qyteti Mesjetar i Novobërdës" dhe "Kujtesa e Kosovës-rrëfimet e të mbijetuarve të masakrës së Krushës së Madhe" pavarësisht ndryshimeve të nevojshme sipas kërkesave të menaxhërve për zgjatje të afatit të punimeve, nuk është aplikuar procedura e amendamentimit të tyre, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullative në fuqi. Si rrjedhojë, realizimi i punimeve/pagesave është zhvilluar pa reflektuar këto ndryshime në dokumentacionin kontraktual përkatës.

Mungesa e kontrolleve të brendshme efektive në zyrën e prokurimit për identifikimin dhe formalizimin me kohë të ndryshimeve kontraktuale, duke rezultuar në mosaplikimin e procedurave të amendamentimit të kontratës.

Ndikimi

Mosamendamenti i kontratës në rastet kur ndryshojnë kushtet e saj, duke u mbështetur vetëm në nxjerrjen e një vendimi dhe marrjen e aprovimit nga ZKA, mund të rezultojë në realizimin e punëve/shërbimeve pa bazë të plotë kontraktuale dhe përbën shkelje të procedurave të përcaktuara.

Rekomandimi A13

Ministri duhet të forcojë i kontrolleve të brendshme në zyrën e prokurimit që çdo ndryshim në kushtet e kontratës të formalizohet përmes amendamentimit përkatës, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale në fuqi,

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit

Gjate auditimit u identifikuan disa çështje që iu komunikuan menaxhmentit dhe u zgjidhen në mënyrë efektive gjatë auditimit aktual. Ato nuk kërkojnë ndonjë veprim të mëtutjeshëm dhe raportohen vetëm me qëllim të dokumentimit të komunikimit në fjalë, veprimeve të ndërmarra dhe rezultateve të tyre. Këto ishin si më poshtë:

Çështja 1

Korrigjimi i Pasqyrave Vjetore Financiare

Gjetja

Gjatë rishikimit të Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV), krahasimit me buxhetin dhe shpenzimet, si dhe shqyrtimit të shënimeve shpjeguese, janë identifikuar disa mospërputhje si në vijim:

- Neni 14-Raporti i ekzekutimit të buxhetit, Dalja e parasë së gatshme, buxheti fillestar dhe final ishte prezantuar në vlera të plota dhe jo sipas formatit të kornizës së raportimit financiar. Si rezultat, vlerat e prezantuara ishin mbivlerësuar për 82,680,483€, përkatësisht për 86,312,647€ (të shprehura në '000€). E njëjta ishte reflektuar edhe tek kolona e ndryshimit të buxhetit;
- Neni 14.6-Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit, te të hyrat jo tatimore, buxheti përfundimtar ishte prezantuar me vlerë të plotë duke shkaktuar mbivlerësim për 124,138€ (të shprehur në '000€).
- Po ashtu, janë identifikuar mangësi të cilat kanë reflektuar në prezantimin jo të drejtë të shënimeve dhe shpalosjeve, si shënimet 2, 3, 5 dhe 6, të cilat kishin të bënin me prezantim jo të drejtë të të dhënave të buxhetit apo konsistencës me të dhënat e prezantuara në pasqyrat kryesore.

Veprimi i kërkuar

Rishikimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2025, i kryer nga ekipi i auditimit, ka nxjerrë në pah nevojën për korrigjimin e tyre, me qëllim sigurimin e paraqitjes së drejtë dhe të besueshme të vlerave financiare, duke marrë parasysh ndikimin material të identifikuar.

Rezultati

Kjo çështje është korrigjuar nga MKRS, pas konsultimeve me ekipin e auditimit, brenda afateve ligjore të përcaktuara nga Ministria e Financave.

4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull paraqitet një përmbledhje e burimeve të fondeve buxhetore, ecurisë së shpenzimeve të realizuara, të strukturuar sipas kategorive ekonomike. Këto të dhëna janë ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve përkatës në vijim:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁷	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Burimet e fondeve	86,399,046	82,762,342	72,509,851	62,249,462	46,211,509
Grante Qeveritare - Buxheti	86,272,956	82,272,791	72,279,098	62,108,869	46,078,554
Të bartura nga viti i kaluar	0	39,101	6,528	11,652	4,828
Të hyrat vetanake	126,090	126,090	9,054	8,250	23,178
Donacionet vendore	0	18,898	10,000	0	10,000
Donacionet e jashtme	0	305,463	205,170	120,691	94,949

Buxheti përfundimtar është më i ulët se buxheti fillestar për 3,636,704€, kryesisht si rezultat i vendimeve të Qeverisë për kursime buxhetore.

MKRS ka shpenzuar buxhetin e vitit 2025 në nivel prej 88%, që paraqet një nivel më të mirë krahasuar me vitin paraprak.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	86,399,046	82,762,342	72,509,851	62,249,462	46,211,509
Pagat dhe mëditjet	7,317,717	8,249,110	8,236,282	6,702,027	6,226,003
Mallrat dhe shërbimet	5,040,871	7,016,572	6,123,405	5,993,349	4,553,493
Komunalitë	483,908	441,533	300,655	297,419	394,313
Subvencionet dhe transferet	17,116,550	23,096,388	22,978,674	23,084,508	22,037,975
Investimet Kapitale	56,440,000	43,958,740	34,870,835	26,172,158	12,999,725

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje, krahasuar me buxhetin fillestar, shënoi një rritje prej 931,394 €. Kjo rritje erdhi si rezultat i vendimeve të Qeverisë, si dhe mbështetjes financiare nga grantet e donatorëve të BE-së dhe Fondi Global. Po ashtu, rritja e vlerës së koeficientit për 0.5% pasi që rritja reflekton në vlerën bazë të përlogaritjes së tyre për të mbuluar shpenzimet e pagave. Shpenzimi i buxhetit final për këtë kategori ishte 99.84%;
- Buxheti për mallra dhe shërbime ishte rritur për 1,975,701€. Rritja buxhetore ishte rezultat i transfereve buxhetore në vlerë 1,180,269 €, si dhe ndarjet dhe kursimet sipas vendimeve të Qeverisë në shumën 581,515€. Gjithashtu, në këtë total janë përfshirë të hyrat e bartura nga viti paraprak në vlerë 39,101€ dhe grantet e përcaktuara nga donatorët në shumën 175,721€. Rritja e buxhetit është rezultat edhe i transfereve të brendshme ndërmjet kategorive ekonomike, vendimeve të Qeverisë për ndarje dhe kursime buxhetore, mbështetjes nga donatorët dhe të hyrat e bartura nga viti paraprak. Shpenzimi i buxhetit për këtë kategori ishte 87%;
- Buxheti final për komunalitë shënoi një ulje prej 42,375€, si rezultat i vendimit të Qeverisë për kursime buxhetore. Shkalla e shpenzimit për këtë kategori arriti në 68%.
- Buxheti për kategorinë e subvencione dhe transfere ishte rritur për vlerën 5,979,838€, nga i cili ishin shpenzuar 99%. Ndryshimet në buxhet janë rezultat i vendimeve të Qeverisë për ndarje buxhetore, riorientimit të mjeteve përmes transfereve nga kategorita e investimeve kapitale dhe mallra e shërbime në subvencione; si dhe
- Buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 12,481,260€, si rezultat i mos shpenzimit të fondeve. Shpenzimet krahasuar me buxhetin final ishin 79%. Realizimi i buxhetit në këtë nivel ishte si rezultat i menaxhimit jo të duhur të kontratave dhe vonesave në përmbushjen e kontratave gjatë realizimit të projekteve të planifikuara.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Të hyrat e realizuara nga MKRS në 2025 ishin në vlerë 264,878€. Këto të hyra janë realizuar kryesisht nga: taksat administrative, participimet dhe të hyrat nga viti i kaluar.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
Totali i të hyrave	124,262	124,262	264,878	78,929	88,847
Të hyrat jo tatimore	124,262	124,262	178,509	51,648	65,999
Të hyrat tjera	0	0	86,369	27,281	22,848

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) të vitit 2024 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve ka rezultuar me gjithsej 17 rekomandime. Në përgjigje të tyre, Ministria ka hartuar një Plan Veprimi, në të cilin është përcaktuar mënyra e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

Deri në përfundim të auditimit për vitin 2025, gjashtë (6) rekomandime janë zbatuar, një (1) ishte pjesërisht i zbatuar, ndërsa dhjetë (10) mbeten ende të pazbatuara, siç ilustron në Grafikon 2 më poshtë.

Për një pasqyrë më të detajuar të rekomandimeve dhe mënyrës së trajtimit të tyre, referojuni Tabelës 4 (Tabelës së rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Ministri përmes zyrtarëve përgjegjës duhet të sigurojë se, aplikohet regjistrimi i pasurive kapitale dhe jo kapitale me qëllim të ruajtjes së pasurisë dhe paraqitjes së drejtë të vlerës së tyre në PFV.	Nuk janë identifikuar raste të njëjta.	I zbatuar
2.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen konform kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre sipas standardeve të kontabilitetit të sektorit publik në përputhje me planin kontabël.	Gjatë vitit 2025 nuk janë identifikuar pagesa të cilat nuk ishin klasifikuar drejtë në kodet ekonomike.	I zbatuar

3.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të siguroj se të gjitha projektet e subvencionuara arsyetohen në kohën e paraparë dhe të jenë konform kërkesave të memorandumit, mbështetur me dokumente valide të parapara me rregulloren për subvencione dhe transfere. Në rastet e mos arsyetimit të subvencioneve, të ndërmerren veprimet ligjore, siç parashihet me marrëveshjet përkatëse.	Edhe në vitin 2025 janë identifikuar raste të ngjashme të vonesave në arsyetimin e subvencioneve.	Nuk ka filluar zbatimimi
4.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të sigurojë vendosjen e një sistemi efektiv në të cilin të gjitha faturat të procedohen me kohë për pagesë sipas afatit të përcaktuar ligjor.	Edhe gjatë vitit 2025 janë evidentuar raste të ngjashme të vonesave në përmbushjen e obligimeve të pagesave.	Nuk ka filluar zbatimimi
5.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të sigurojë që buxheti i planifikuar për subvencionim të jetë në përputhje me kufizimet buxhetore dhe që financimet tjera të realizohet në mënyrë transparente dhe të justifikueshme, duke shmangur obligimet pa buxhet dhe duke siguruar që projektet e përkrahura të jenë në përputhje me objektivat e përcaktuara.	MKRS nuk ka ndërmarrë veprime për adresimin e kësaj çështje.	Nuk ka filluar zbatimimi
6.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të siguroj respektimin e afateve ligjore të përcaktuara me ligj për ushtrues detyre, finalizimin e legjislationit të brendshëm me qëllim të plotësimit të pozitave me staf të rregullt të punës.	MKRS kishte harmonizuar vendimet sipas ndryshim-plotësimit të Ligjit për Zyrarët Publik me Nr. 08/L-094.	I zbatuar
7.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të sigurojë që të gjitha avancet për udhëtime zyrtare duhet të arsyetohen dhe shumat e pashpenzuara të kthehen në afat prej 15 ditësh pas kthimit nga udhëtimi. Në të kundërtën, duhet të sigurojë marrjen e veprimeve ligjore ndaj personave përgjegjës të cilët nuk i kanë arsyetuar ose kthyer mjetet e pranuar-avancet.	Edhe në vitin 2025 janë identifikuar raste të ngjashme.	Nuk ka filluar zbatimimi
8.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të siguroj që të gjitha proceset e rekrutimit bëhen në përputhje me rregullat dhe ligjet e përcaktuara, duke iniciuar konkurse të hapura dhe publike për çdo pozitë të lirë. Është thelbësore që të respektohen kriteret dhe procedurat e rekrutimit për të garantuar transparencë dhe barazi në proceset e punësimit.	Rekomandimi është adresuar.	I zbatuar

9.	Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të siguroj që të përshpejtohet procesi i hartimit dhe miratimit të rregulloreve, duke siguruar koordinim të ngushtë mes institucioneve dhe respektimin e afateve të përcaktuara sipas rregulloreve në fuqi.	MKRS nuk ka zbatuar rekomandimin e dhënë, edhe gjatë vitit 2025 kemi identifikuar që nuk është hartuar Rregullorja e brendshme për sistematizimin e vendeve të punës.	Nuk ka filluar zbatimin
10.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitetë	Ministri duhet të forcojë mekanizmat e kontrollit të brendshëm për menaxhimin e kontratave kornizë, duke siguruar që shpenzimet të jenë në përputhje vlerat e kontraktuara, me qëllim të shmangjes së tejkalimeve buxhetore dhe përdorimit efikas të buxhetit të saj.	Mekanizmat e kontrollit të brendshëm për menaxhimin e kontratave kornizë nuk janë forcuar, duke rezultuar në vazhdim të mospërputhjeve ndërmjet shpenzimeve dhe vlerave të kontraktuara.	Nuk ka filluar zbatimin
11.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitetë	Ministri duhet të forcojë kontrollet e brendshme për të parandaluar vonesat dhe mosrespektimin e afateve, duke planifikuar më mirë procesin e furnizimit dhe trajnimeve, dhe duke siguruar që operatorët ekonomikë të respektojnë afatet dhe kushtet e përcaktuara.	Nga mostrat e testuara nuk kemi hasur raste të tilla.	I zbatuar
12.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitetë	Ministri duhet të siguroj që pozitat e rregullta të punës të përfshihen në planin e rekrutimeve dhe rekrutimi i tyre të bëhet përmes procedurave të rregullta të rekrutimit në përputhje me kërkesat ligjore.	Pozitat e rregullta të punës nuk janë përfshirë në mënyrë adekuate në planin e rekrutimeve dhe angazhimi i tyre ka vazhduar të mos realizohet përmes procedurave të rregullta, në përputhje të plotë me kërkesat ligjore.	Nuk ka filluar zbatimin
13.	Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të sigurojë që komisionet për vlerësimin dhe ankesa të formohen në përputhje me rregullore dhe të përfshijnë anëtarë nga të gjithë departamentet përkatëse, për të siguruar paanshmërinë, transparencën dhe respektimin e procedurave ligjore.	MKRS edhe në vitin 2025 kishte mangësi në formimin e komisioneve vlerësues me rastin e subvencionimit.	Pjesërisht i zbatuar

14.	Investimet kapitale	Ministri duhet të siguroj që njoftimi paraprak të përgatitet dhe publikohet në përputhje me rregullat e përcaktuara në Rregulloren për Prokurim Publik.	Ministria nuk ka përgatitur publikimin e njoftimit paraprak as në vitin 2025.	Nuk ka filluar zbatimi
15.	Investimet kapitale	Ministri përmes zyrtarëve përgjegjës duhet të sigurojë një analizë gjithëpërfshirëse të projekteve të filluara dhe të identifikojë arsyet e vonesave të kontratave dhe marrjen e veprimeve për realizimin/përfundimin e tyre.	Edhe gjatë vitit 2025 janë evidentuar raste të vonesave në realizimin e punimeve.	Nuk ka filluar zbatimi
16.	Investimet kapitale	Ministri duhet të sigurojë që të gjithë menaxherët e projekteve, aplikojnë menaxhimin e kontratave përmes sistemit elektronik të prokurimit publik, me qëllim të mbikëqyrjes më të lehtë nga menaxhmenti apo përdoruesit tjerë të mundshëm.	Janë identifikuar raste të njëjta, nuk është përdorur moduli e-prokurimi për menaxhimin e kontratave.	Nuk ka filluar zbatimi
17.	Çështjet e përbashkëta	Ministri duhet që të rris nivelin e kontrollit dhe llogaridhënies që njësitë kërkuese, gjatë hartimit të specifikimeve teknike, të përfshijnë patjetër shprehjen “ose ekuivalent” kur përmenden emërtime apo produkte specifike, në mënyrë që të respektohen kërkesat ligjore.	Nuk janë identifikuar raste të njëjta.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Mjellma Dibra, Drejtore e Auditimit



Kreshnike Haziri-Bublica, Udhëheqëse e ekipit



Albana Sahiti, Anëtare e ekipit



Fetah Osmani, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Nënshkrimi i kontratave pa verifikimin paraprak të sigurimit të ekzekutimit	<p>Kjo e gjetur konsiderojmë se nuk pasqyron saktë përgjegjësitë ligjore të Autoritetit Kontraktues dhe të Zyrës së Prokurimit.</p> <p>Të gjitha policat e sigurimit të dorëzuara nga operatorët ekonomikë gjatë procedurave të prokurimit kanë qenë të nënshkruara dhe të vulosura nga kompania e sigurimit, duke përbushur të gjitha elementet formale të një dokumenti të rregullt.</p> <p>Në momentin e pranimit dhe vlerësimit të tyre nuk ka ekzistuar asnjë rrethanë objektive që do të ngrinte dyshime mbi autenticitetin ose vlefshmërinë e tyre.</p> <p>Në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik dhe aktet nënligjore në fuqi, Zyra e Prokurimit dhe komisionet e vlerësimit kanë për obligim të verifikojnë vërtetësinë dhe validitetin e dokumenteve nëse operatori ekonomik ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar sipas Dosjes së Tenderit, në kuptimin e hetimit administrativ për vlefshmëri sepse ato, prezumohen të sakta në mënyrën se si janë dorëzuar në përgjegjësinë juridike të ofertuesit.</p> <p>Ndërkaq, përgjegjësia për ligjshmërinë, vërtetësinë dhe vlefshmërinë e dokumenteve të dorëzuara i takon operatorit ekonomik, i cili këtë përgjegjësi e merr përsipër përmes Deklaratës nën Betim.</p> <p>Legjislacioni i prokurimit publik nuk parashikon obligim që Zyra e Prokurimit ose komisionet e vlerësimit të zhvillojnë hetime administrative apo të verifikojnë autenticitetin e secilit dokument të</p>	<p>E gjetura mbetet e pandryshuar. Edhe pse përgjegjësia për vërtetësinë e dokumenteve të dorëzuara i takon operatorit ekonomik, Autoriteti Kontraktues ka përgjegjësi të sigurojë që instrumentet e sigurimit të pranuar në procedurat e prokurimit janë valide dhe ofrojnë mbrojtjen e nevojshme të interesit publik.</p> <p>Fakti që pas identifikimit të parregullsive janë ndërmarrë veprime për verifikimin dhe zëvendësimin e policave dëshmon se verifikimi i vlefshmërisë së tyre ka qenë i mundur dhe i nevojshëm. Për rrjedhojë, konsiderojmë se kontrollet e tilla është dashur të aplikoheshin edhe në momentin e pranimit të policave.</p>

lëshuar nga institucione ose subjekte të treta. Përkundrazi, autoriteti kontraktues vepron mbi parimin e prezumimit të vlefshmërisë së dokumenteve zyrtare të lëshuara nga autoritetet kompetente, derisa të provohet e kundërta nga organet përgjegjëse.

Nëse Autoriteti Kontraktues do të kishte detyrimin të verifikonte individualisht autenticitetin e çdo dokumenti të dorëzuar nga operatorët ekonomikë, siç janë policat e sigurimit, vërtetimet tatimore, garancitë bankare, certifikatat apo dokumente të tjera të lëshuara nga institucione të ndryshme, atëherë kjo do të tejkalonte kompetencat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi dhe do ta bënte praktikisht të pamundur zhvillimin e procedurave të prokurimit brenda afateve ligjore. Pikërisht për këtë arsye, ligjvënësi e ka vendosur barrën e përgjegjësisë mbi operatorin ekonomik përmes Deklaratës nën Betim dhe ka paraparë masa ligjore në rast të paraqitjes së dokumenteve të pavërteta.

Menjëherë pasi Autoriteti Kontraktues është njoftuar nga kompania e sigurimeve përmes një emaili për parregullsitë që kishin ndodhur brenda kompanisë së sigurimit, janë ndërmarrë pa vonesë të gjitha veprimet e nevojshme për mbrojtjen e interesit publik dhe të mjeteve publike. Është kërkuar zëvendësimi i policave të sigurimit me polisa të rregullta dhe të konfirmuara nga kompania përkatëse e sigurimit, duke siguruar që të gjitha kontratat të mbulojnë me instrumente valide sigurimi.

Për më tepër, Zyra e Prokurimit ka ndërmarrë masa shtesë kontrolli nga detyra zyrtare dhe jo nga një urdhër administrativ i parashikuar shprehimisht në rregulla, duke kërkuar verifikimin e vazhdueshëm të policave të sigurimit pranë kompanive përkatëse, me qëllim të parandalimit të rasteve të ngjashme në të ardhmen. Megjithatë, duhet të konsideruar se kjo është bërë nga

	<p>detyra zyrtare dhe jo se një rregull i procedurës, e parashikon qartazi një detyrim të tillë të autoritetit.</p> <p>Deklarata nën betim është parashikuar pikërisht për të precizuar përgjegjësinë për validitetin e dokumentacionit dhe ofertave të dorëzuara e që këtë deklaratë, rregullat ja mveshin si përgjegjësi operatorëve prandaj edhe përgjegjësia është e operatorëve.</p> <p>Prandaj, konsiderojmë se përgjegjësia për parregullsitë e konstatuara nuk mund t'i atribuohet Autoritetit Kontraktues apo Zyrës së Prokurimit, pasi ato burojnë nga veprime të brendshme të kompanisë së sigurimit dhe nga dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik, për vërtetësinë e të cilit ai mban përgjegjësi të plotë ligjore.</p> <p>Për rrjedhojë, kërkujmë që kjo e gjetur të rishqyrtohet dhe të largohet ose të riformulohet, pasi në formën aktuale i atribuon Autoritetit Kontraktues përgjegjësi që nuk burojnë nga Ligji për Prokurimin Publik dhe aktet nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Anashkalimi i thirrjes publike në financimin e aktiviteteve shtesë të organizatave sportive</p>	<p>Nuk pajtohem</p> <p>Çështja A7 - Anashkalimi i thirrjes publike në financimin e aktiviteteve shtesë të organizatave Sportive</p> <p>Organizatave përfituese në rastet e evidentuara janë federata sportive të licencuara nga Ministria përgjegjëse për Sport, të cilat veprojnë si organizatat e vetme kombëtare për sportet përkatëse dhe kanë mandat ligjor për përfaqësimin e Republikës së Kosovës.</p> <p>Për aktivitetet ndërkombëtare që janë objekt i kësaj gjetjeje, Ministria e Sportit ka njoftuar federatat sportive përmes komunikimit zyrtar elektronik (e-mail) që të paraqesin kërkesat dhe dokumentacionin përkatës për organizimin e aktiviteteve ndërkombëtare në Republikën e Kosovës. Duke pasur parasysh se organizimi i këtyre aktiviteteve mund të realizohet vetëm nga federatat përkatëse të</p>	<p>E gjetura mbetet e pandryshuar. Rregullorja (QRK)-Nr. 36/2024 e specifikon qartë financimin e federatave sportive, e cila ka hyrë në fuqi në fund të vitit 2024. Financimi për aktivitetet shtesë të federatave sportive bëhet përmes thirrjes publike sipas nenit 18.</p> <p>Fakti që në vitin 2026 është aplikuar thirja publike për këtë lloj financimi e dëshmon që e gjetura qëndron.</p>

licencuara, nuk ka ekzistuar konkurrencë ndërmjet subjekteve të ndryshme për të njëjtin aktivitet. Për më tepër aktivitetet e financuara përbëjnë ngjarje ndërkombëtare specifike të cilat janë dhënë nga federatat ndërkombëtare ekskluzivisht federatave përkatëse kombëtare, dhe si të tilla nuk mund të realizohen nga organizata të tjera sportive.

Rrjedhimisht qëllimi i thirrjes publike, sigurimi i qasjes së barabartë dhe mundësisë së aplikimit për subjektet e interesuara, është përmbushur përmes njoftimit dhe ftesës drejtuar të gjitha federatave sportive të licencuara që mund të ishin bartëse të aktiviteteve të tilla, ndërsa për aktivitetet konkrete ekzistonte vetëm një përfitues i mundshëm sipas mandatit ligjor dhe sportiv.

Gjithashtu financimi është realizuar pas vlerësimit të kërkesave, dokumentacionit mbështetës, vendimeve të federatave ndërkombëtare për dhënien e organizimit dhe interesit publik që këto ngjarje paraqesin për Republikën e Kosovës në aspektin e zhvillimit të sportit, promovimit ndërkombëtar dhe diplomacisë sportive.

Për rrjedhojë konsiderojmë se nuk kemi të bëjmë me anashkalim të parimeve të transparencës apo favorizim të subjekteve të caktuara, por me financim të aktiviteteve të veçanta ndërkombëtare që për nga natyra e tyre mund të organizohen vetëm nga federatat sportive kombëtare përkatëse të licencuara dhe të njohura nga organizatat ndërkombëtare sportive.

Për më tepër, me qëllim të standardizimit të procedurave dhe adresimit të rekomandimeve të dhëna në vitin 2026 kemi shpallur thirrje publike të veçantë për financimin e organizimit të aktiviteteve ndërkombëtare sportive që zhvillohen në Republikën e Kosovës. Përmes kësaj thirrjeje janë përcaktuar kriteret, kushtet dhe procedurat e aplikimit për të gjitha

	federatat sportive të licencuara, duke siguruar një proces të unifikuar.	
Pagesa të paradhënies në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi	<p>Nuk pajtohem</p> <p>Çështja A8 - Pagesa të paradhënies në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi</p> <p>Në lidhje me konstatimin e paradhënies për kontratën e projektit “Renovimi i Pallatit të Rinisë” në dhjetor është ekzekutuar pagesa e avancit për 15% (171,778€) të vlerës së kontratës, në vend të 57,259€ (5%) sa ishte e lejuar, ku gjetja lidhur me pagesën e avancit për projektin e Teatrit Oda, e cila është cilësuar si tejkalim i përqindjes së lejuar të avancit në muajt e fundit të vitit buxhetor, në rastin konkret, kërkesa për pagesë avansi është dorëzuar gjatë muajit tetor, gjegjësisht më datë 24.10.2025, fatura përkatëse është lëshuar poashtu në muajin tetor, më datë 23.10.2025 dhe aprovimi i pagesës është bërë po ashtu gjatë muajit tetor. Në momentin e pranimit dhe aprovimit të kërkesës ka qenë në fuqi kufizimi ligjor që lejonte pagesën e avancit deri në 15% të vlerës së kontratës, përqindje e cila është respektuar plotësisht nga institucioni. Ne kemi pas parasysh se lindja e detyrimit juridik dhe kontraktual për pagesën e avancit ndodh në momentin e pranimit dhe aprovimit të kërkesës/faturës, e jo në momentin e ekzekutimit teknik të pagesës nga sistemi financiar. Për rrjedhojë, ne konsiderojmë se data e ekzekutimit nuk mund të shërbejë si bazë për aplikimin retroaktiv të kufizimeve që kanë hyrë në fuqi për muajt nëntor dhe dhjetor në këtë rast. Kufizimet e parapara në Ligjin për Ndarjet Buxhetore Vjetore për pagesat e avanceve në muajin nëntor (10%) dhe dhjetor (5%) kanë të bëjnë me obligimet që krijohen, pranohen dhe aprovohen gjatë këtyre periudhave. Në rastin e Teatrit Oda, obligimi është krijuar dhe aprovuar në muajin tetor, kur</p>	<p>E gjetura qëndron e pandryshuar. Ligji për Ndarjet Buxhetore Vjetore përcakton kufizime të qarta për vlerën e paradhënies që mund të paguhet gjatë muajve nëntor dhe dhjetor. Rrjedhimisht, përkundër arsytimit të Ministrisë për kohën e miratimit të kërkesave kjo nuk e arsyeton mosrespektimin e kufizimeve ligjore për pagesat e paradhënies. Kjo çështje ndikon në likuiditetin dhe menaxhimin e parasë në momentin e ekzekutimit të pagesave.</p> <p>Për projektin në Gjilan, si bashkëfinancuese, MKRS mban përgjegjësi për përdorimin e mjeteve buxhetore të transferuara, ndërsa nuk janë ofruar dëshmi të mjaftueshme për destinimin e paradhënies sipas kushteve kontraktuale.</p>

pagesa e avansit prej 15% ishte plotësisht në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Prandaj, konsiderojmë se gjetja duhet rishikuar, pasi pagesa në fjalë nuk përfaqëson një obligim të krijuar në muajt nëntor apo dhjetor, por ekzekutim të një detyrimi të rregullt kontraktual dhe financiar të krijuar, dokumentuar dhe aprovuar paraprakisht në muajin tetor, në pajtim të plotë me legjislacionin në fuqi.

Lidhur me konstatimin e paraqitur për pagesën e avansit në kontratën e projektit “Ndërtimi i Stadiumit të Qytetit në Ferizaj”, sipas të cilit në muajin dhjetor është paguar avans në vlerë prej 1,734,209 € (10% e vlerës së kontratës), në vend të 867,105 € (5%), sa pretendohet se ishte e lejuar, sqarojmë si vijon: Kërkesa për pagesën e avansit është dorëzuar më 27.11.2025, ndërsa fatura përkatëse është lëshuar po në të njëjtën datë. Pas verifikimit të dokumentacionit dhe hapjes së periudhës përkatëse në SIMFK, pagesa është aprovuar më 03.12.2025.

Në momentin e pranimit dhe aprovimit të kërkesës për avans, ishte në fuqi dispozita ligjore që lejonte pagesën e avansit deri në 10% të vlerës së kontratës, për qindje e cila është respektuar plotësisht nga institucioni. Për më tepër, ekzekutimi i pagesës në muajin dhjetor ka qenë rezultat i procedurave administrative dhe teknike të përpunimit në sistemin financiar dhe nuk ndryshon natyrën juridike të obligimit të krijuar paraprakisht.

Për projektin “Qendra Multifunkionale në Dragash” është realizuar pagesë avansi në shumën prej 100,000.00 €, në vend të 98,995.00 € (10%) sa pretendohet se ishte e lejuar, sqarojmë:

Në rastin konkret, fatura për pagesën e avansit është pranuar më 31.10.2025, ndërsa kërkesa për pagesë është dorëzuar po në të njëjtën datë, duke kërkuar pagesën e avansit në vlerë prej 15% të

kontratës. Raporti i pranimit është përpiluar më 04.11.2025, ndërsa pagesa në shumën prej 100,000.00€ është realizuar më 14.11.2025, pas verifikimit të dokumentacionit përkatës.

Megjithëse fatura e pranuar ishte në vlerë prej 148,492.94€, pagesa është realizuar vetëm në shumën prej 100,000.00€, për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore të disponueshme në atë periudhë.

Me rastin e pranimit të faturës dhe krijimit të obligimit financiar, ka qenë në fuqi dispozita ligjore që lejonte pagesën e avansit deri në 15% të vlerës së kontratës, përqindje e cila është respektuar plotësisht nga institucioni. Rrjedhimisht, obligimi kontraktual dhe financiar është krijuar në një periudhë kur pagesa e avansit në këtë përqindje ishte e lejuar sipas legjislacionit në fuqi. Nuk pajtohem me konstatimin se për projektin "Stadiumi i Prizrenit" pjesa e avansit e ekzekutuar në muajin dhjetor në shumën prej 707,558 € ka tejkaluar kufirin e lejuar prej 603,779 € (5% e vlerës së kontratës).

Në këtë rast, fatura për pagesën e avansit është pranuar për shumën prej 1,207,557.48 € me datë 19.11.2025, që përfaqëson 10% të vlerës së kontratës, në përputhje me kushtet kontraktuale dhe dispozitat ligjore në fuqi në kohën e krijimit të obligimit.

Për shkak të disponueshmërisë së mjeteve buxhetore dhe procedimit teknik të pagesave, avansi është ekzekutuar në tri faza:

- pagesa e parë më 24.11.2025 në shumën prej 500,000.00€;
- pagesa e dytë më 03.12.2025 në shumën prej 234,210.00€;
- pagesa e tretë më 04.12.2025 në shumën prej 473,348.00€.

Me rastin e pranimit, shqyrtimit dhe aprovimit të kërkesës për avans, ka qenë në fuqi dispozita ligjore që lejonte pagesën e avansit deri në 10% të vlerës së kontratës, përqindje e cila është respektuar plotësisht nga institucioni.

Vlerësojmë se obligimi juridik dhe

financiar është krijuar në momentin e pranimit dhe aprovimit të kërkesës për pagesë të avansit, e jo në momentin e ekzekutimit teknik të pagesës. Ndarja e pagesës në disa transaksione nuk ndryshon natyrën e obligimit dhe as periudhën kur ai është krijuar. Pagesat e realizuara në muajin dhjetor përfaqësojnë vetëm ekzekutimin e pjeshëm të një obligimi të krijuar dhe aprovuar më herët, në kohën kur pagesa e avansit deri në 10% të vlerës së kontratës ishte e lejuar sipas legjislacionit në fuqi.

Për projektin “Renovimi i kompleksit të sportit dhe palestra sportive në Gjilan” me vlerë kontrate 2,878,876€, është realizuar pagesë në mars 2025 në vlerë 13% ose 383,000€, pa dëshmi të mjaftueshme për destinimin e mjeteve siç ishte e specifikuar në kushtet e veçanta të kontratës.

Sqarojmë se: Në Kushtet e Veçanta të Kontratës - Neni 26.1

(Parapagimi), është paraparë që Autoriteti Kontraktues të kryejë pagesë paraprake ndaj Operatorit Ekonomik. Edhe pse në përshkrimin fillestar nuk është specifikuar qartë se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) do të mbështesë financiarisht pjesën më të madhe të projektit, praktika e deritanishme tregon se shpenzimet kryesore mbulohen nga buxheti i MKRS. Kjo nuk e pengon që pagesa të ekzekutohet nga institucioni mbështetës - në këtë rast Komuna e Gjilanit - e cila, në përputhje me kërkesën e Operatorit Ekonomik, ka ndërmarrë procedurat për realizimin e pagesës paraprake.

Në Memorandumin e Bashkëpunimit ndërmjet MKRS dhe Komunës së Gjilanit nuk është përcaktuar në mënyrë eksplicite obligimi për parapagim, por po ashtu nuk është ndaluar një pagesë e tillë. Duke qenë se MKRS nuk është palë kontraktuese, por vetëm mbështetëse financiare, të gjitha procedurat e kontraktimit dhe dokumentacionit për pagesë zhvillohen nga Komuna e Gjilanit.

	<p>MKRS, si mbështetës financiar, e përkrah këtë proces konform Memorandumit të Bashkëpunimit, duke siguruar mbështetje për realizimin e projektit.</p> <p>Në Kushtet e Veçanta të Kontratës, Neni 26.1 - Parapagimi, është bërë referencë në Ligjin për Buxhetin lidhur me parapagimet. Në këtë nen është përcaktuar qartë edhe përqindja e parapagimit, e cila është 15%. Ky specifikim është kontraktual dhe i lidhur drejtpërdrejt me Operatorit Ekonomik dhe Komunës së Gjilanit. Në këtë kuadër, kërkesa për pagesë është pranuar dhe është trajtuar në përputhje me përshkrimin e dhënë në Kushtet e Veçanta të Kontratës.</p> <p>Duke u bazuar në sa më sipër, veprimet e ndërmarra nga Komuna e Gjilanit janë në përputhje me dispozitat kontraktuale dhe ligjore, ndërsa MKRS ka ofruar mbështetjen e saj financiare në përputhje me Memorandumin e Bashkëpunimit. Kjo qasje siguron transparencë, respektim të procedurave ligjore dhe përmbushje të obligimeve kontraktuale ndaj Operatorit Ekonomik.</p> <p>Ndërkohë, kjo e gjetur nuk mund t'i atribuohet MKRS -së sepse ky projekt, sikurse u sqarua, zhvillohet me bashkëfinancim dhe procedurat e prokurimit që nënkupton se përgjegjësinë për menaxhimin e kontratës dhe vendosjen e kontrolleve e ka një institucion tjetër dhe jo MKRS, prandaj mendojmë se kjo e gjetur duhet të largohet ose të riformulohet në përputhje me përgjegjësitë objektive ligjore.</p> <p>Përfundim: gjendja e dokumentacionit të lendeve ku janë paguar paradhënie, ne asnjë rast nuk rezulton që të jete miratuar pagese apo pranuar fature ne afate ku kufizohen përqindjet e lejuara per paradhënie sipas Ligjit per Ndarjet Vjetore Buxhetore, pavarësisht periudhës se ekzekutimit.</p>	
Mungesa e lejes ndërtimore para inicimit të projekteve	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka ndërmarrë me kohë të gjitha veprimet e nevojshme për	Gjetja qëndron. MKRS nuk është pajisur me një leje ndërtimore të lëshuar në formë të

kapitale	<p>njoftimin dhe përcjelljen e procedurave lidhur me pajisjen me leje ndërtimore, duke adresuar kërkesat dhe shkresat përkatëse tek komunat kompetente, në rastet kur MKRS-ja është hartuese e projekteve në bashkëpunim me federatat përkatëse.</p> <p>Si dëshmi e angazhimit dhe ndjekjes së vazhdueshme të procesit, posedohen komunikimet elektronike dhe shkresat zyrtare lidhur me projektin e Stadiumit të Qytetit në Suharekë, përmes të cilave është kërkuar informatë nga Komuna e Suharekës lidhur me ecurinë e procedurës për pajisjen me leje ndërtimore për Stadiumin e Futbollit në Suharekë.</p> <p>MKRS aplikimin për leje /MKRS e ka bërë në pjesën e parë të muajit korrik ndërsa punimet kanë filluar në shtator vetëm pas kalimit të afatit ligjor për shqyrtim dhe vendosje të kërkesës tonë si palë dhe nga gjendja juridike ne kemi qenë në kushtet e posedimit të lejes ndërtimore. Ligji Nr.05/L - 031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative Neni 100 Akti administrativ i miratuar në heshtje 1. Nëse pala ka kërkuar nxjerrjen e një akti administrativ të shkruar dhe organi publik nuk e njofton palën për aktin administrativ brenda afatit fillestar dhe nuk njofton shtyrjen apo nuk njofton për aktin brenda afatit të shtyrë, sipas nenit 98 gjegjësisht 99 të këtij Ligji, kërkesa e bërë nga pala do të vlerësohet e pranuar në tërësi dhe akti administrativ i kërkuar nga pala do të vlerësohet të jetë miratuar (në vijim: "akti administrativ i miratuar në heshtje") ndërsa Rrethanën e njëjtë juridike e shkakton edhe ligji material që e rregullon në mënyrë të posaçme raportin juridik ndërmjet palëve dhe autoriteteve publike përkitazi me lejet ndërtimore respektivisht neni 21 (paragrafi 3) i Ligjit Nr. 04/L - 110 për Ndërtim, citim: Nëse kushtet e parapara me këtë ligj janë përmbushur dhe nëse aplikuesi ka paraqitur dëshmi për pagesën e taksës së lejes ndërtimore, organi</p>	<p>shkruar nga organi kompetent para fillimit të punimeve.</p> <p>Referimi në dispozitat ligjore që rregullojnë institutin e "aktit administrativ të miratuar në heshtje" nuk e ndryshon rrethanën faktike se leja ndërtimore nuk është lëshuar dhe nuk i është dorëzuar MKRS-së si akt administrativ formal. Për më tepër, vetë dispozitat e cituara parashohin obligimin e organit kompetent që, edhe në rastet kur konsiderohet se leja është lëshuar për shkak të mosveprimit brenda afateve ligjore, ta nxjerrë dhe ta lëshojë lejen ndërtimore.</p>
----------	--	---

kompetent brenda tridhjetë (30) ditësh për kategorinë I dhe brenda dyzet e pesë (45) ditëve për kategoritë II dhe III e lëshon lejen ndërtimore duke llogaritur nga data e paraqitjes së kërkesës. Nëse organi kompetent nuk e ka informuar aplikuesin për vendimin e tij brenda afatit të përcaktuar do të konsiderohet se leja është lëshuar. Në rastin e tillë, organi kompetent e lëshon lejen ndërtimore.

Në këtë drejtim, janë dërguar njoftime dhe kërkesa për informim përmes email-eve të datës 17.07.2025, 23.07.2025 dhe 24.07.2025, si dhe email-i i datës 06.08.2025 drejtuar Komunës së Suharekës. Gjithashtu, ekzistojnë edhe komunikime të tjera përcjellëse, përfshirë email-in e datës 18.08.2025, të cilat dëshmojnë përpjekjet e vazhdueshme të MKRS-së për të siguruar informata mbi progresin e procedurës së lejes ndërtimore.

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE: 24.06.2026			
BUTORAPORTI / REPORT			
SHTAB / DIVISION			
Nr. Org. / Org. No.	Shif. Klasif. / Classif. Code	Nr. Prot. / Prot. No.	Nr. Faqeve / No. Pages
03	47	1156	35



REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA / VLADA / GOVERNMENT	
MINISTRIA E KULTURËS DHE TURIZMIT - MINISTARKA KULTURE I TURIZMA / MINISTER OF CULTURE AND TOURISM	
Nr. prot. / Prot. No.	Shënjë klas. / Classif. Code
01	87
Nr. Prot./M. / Prot. No.	Data / Date
198 / 2026	24.06.2026
Nënshtkrimi / Prishtinë	

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E KULTURËS DHE TURIZMIT
MINISTARSTVO KULTURËS I TURIZMA
MINISTRY OF CULTURE AND TOURISM

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkresë, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për vitin 2025 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Pajtohem pjesërisht me gjetjet dhe rekomandimet e paraqitura në Draft Raportin e Auditimit. Komentet dhe sqarimet tona janë dhënë dhe adresuar në Tabelën e Komenteve, të cilën e gjeni të bashkëlidhur; si dhe
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin.

Znj. Sara Bogujević
(Ministër në Ministrinë e Kulturës dhe Turizmit),

Data: 24.06.2026, Prishtinë,

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT	
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE	
DATE: 24.06.2026	
BUTORAPORTI / REPORT	
SHTAB / DIVISION	
Nr. Org. / Org. No.	Shif. Klasif. / Classif. Code





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E SPORTIT DHE RINISË
MINISTARSTVO SPORTA I OMLADINE
MINISTRY OF SPORT AND YOUTH

Stamp: REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT
MINISTRIA E SPORTIT DHE RINISË - MINISTAR SPORTA I OMLADINE - MINISTER OF SPORTS AND YOUTH
Nr. prot. 31/2020
Sheq. Vlas
Data 22.06.2020
Nënskrimi
Prishtinë

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për vitin 2025 (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem pjesërisht me gjetjet dhe rekomandimet e paraqitura në Draft Raportin e Auditimit. Komentet dhe sqarimet tona janë dhënë dhe adresuar në Tabelën e Komenteve, të cilën e gjeni të bashkëlidhur; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Begim Gashi
Ministër në Ministrinë e Sportit dhe Rinisë
Data: 22.06.2020, Prishtinë.

Stamp: KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
E AUDITIMIT
NATIONAL AUDIT OFFICE

Nr. Prot.	Nr. Fjalëve
Mr. Prot.	Dr. Stranë
Prot. No.	No. Fjalëve

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁸ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁹, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Shtëpia e familjes Vetimi dhe Kirajtani (105,062€), Qendra Hebraike Prizren (502,929€)⁹, Lokaliteti Dresnik (170,000€), konaku i Mahmut Begollëve në Pejë (256,529€), revitalizimi i rrugës Marin Barleti Prizren (1,189,374€).
- ⁶ Federata E Sports-500,000€, Federata E Sports-300,000€ Federata E Sports -253,000€, Federata E Sports-200,000€, Federata e Volejbollit-231,530€, Federata e Basketbollit-130,100€, Federata e Ping Pongut-124,506€, Federata e Basketbollit -31,786€, Sh.M "Prenk Jakova"-24,025€, Projekti filmik "The Interview"-14,800€, Projekti "Not për Kosovën"-5,000€,
- ⁷ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁸ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁹ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.